


Publikationen

zur rechtlichen Zusammenarbeit

botuar nga
Enti për përfaqësim te Republikës së
Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ
dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e
regjistruar (IRZ)



Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Botimi 1/2019, vëllimi i 8-të, viti i 5-të
Aktuelle Rechtsprechung des EGMR
Newsletter 1/2019, 8. Band, 5. Jahrgang



Republic of North Macedonia
Ministry of Justice

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2019

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 12-70)

Blerina Starova Zlatku (faqe 71-82)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, Drejtor i Fushës së Projektit për Europën Juglindore I (Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi), dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RMV-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe:

Luka Prica – menaxher projekti në IRZ-ë dhe Rita Linderöth, Menaxhere e Lartë e Projektit pranë IRZ-së

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i tij u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
para GJEDNJ-së

dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 1/ 2019, vëllimi i 8-të, viti i 5-të, në gjuhën shqipe

~~~~~

Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von dem mazedonischen  
Regierungsvertreter vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 1/2019, 8. Band, 5. Jahrgang in albanischer Sprache

*Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leserinnen und Leser,*

Sie halten eine neue Ausgabe des bereits im vierten Jahr erscheinenden Newsletters zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richterinnen und Richtern, Staatsanwältinnen und -anwälten sowie Behördenmitarbeiterinnen und -mitarbeitern in Nordmazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Nordmazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Nordmazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der Regierungsvertreterin von Nordmazedonien und Direktorin des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V., der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V., der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., und der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen wie die Allianz SE, die Bayer AG und die Daimler AG sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Nordmazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig.

*Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashura lexuese dhe lexues,*

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të katër të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatorëve de operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtareve dhe gjyqtarëve dhe prokuroreve dhe prokurorëve dhe punonjëseve dhe punonjëseve të organeve administrative në Maqedoninë e Veriut. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë së Veriut ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë e Veriut janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterin), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Shoqata Federale e Juristëve të Ndërmarrjeve (der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V.), Shoqata Gjermane e Kooperativave dhe Raiffeisen-it (der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë

Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch eine institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristinnen und Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen.

Der vorliegende Newsletter wird auch in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> und die albanische unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Praktika gjyqësore, Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle anderen Urteile des EGMR gegen Nordmazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigsten Rechtsprechungen des EGMR sind deshalb mithilfe dieses Newsletters allen Richterinnen und Richtern sowie Staatsanwältinnen und -anwälten in Nordmazedonien zeitnah direkt auf ihren eigenen Schreibtischen zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der

Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Shoqata e Europës Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Allianz SE, Bayer AG dhe Daimler AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoninë e Veriut IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit (MFDK).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislacionit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike.

Edhe ky buletin do të botohet në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së tek adresa

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> dhe versioni në shqip tek adresa

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen

për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.



deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet. Deshalb gilt Herrn Botschafter Thomas Gerberich und seinen Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV), das die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzerinnen und Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Das sind bei der IRZ Herr Luka Prica und Frau Rita Linderöth, die diese Publikation in Bonn als Projektmanager und Senior Projektmanagerin betreut haben und Frau Natascha Andreev-ska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Leserinnen und Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe dieser Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im Dezember 2019

***Danica Djonova LL.M***

*Kommissarische Direktorin des Büros  
für die Vertretung Nordmazedoniens  
vor dem EGMR*

***Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner***

*Leiter des Projektbereichs Südosteuropa I  
(Bosnien und Herzegowina, Montenegro,  
Nordmazedonien und Serbien)*

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlini plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zotit Ambasador Thomas Gerberich dhe kolegëve të tij me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministrinë gjermane të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MFDK), e cila ka mundur punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve dhe përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura .

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegeve dhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këta janë në IRZ-ë Z Luka Prica dhe Zj Rita Linderöth, të cilët janë kujdesur për këtë botim në Bon si Menaxher Projekti dhe si Menaxhere e Lartë Projekti, dhe Zj Natasha Andreevsk-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ-në bashkërendimin me partnerin e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexueset dhe lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, dhjetor 2019

**Danica Djonova LL.M.**

*Drejtoresh e Komanduar e Agjencisë  
për përfaqësimin e Maqedoninëve e Veriut  
para GJEDNJ-së*

**Avokat Dr. Stefan Pürner**

*Drejtor i Fushës së Projektit  
për Europën Juglindore I  
(Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi,  
Maqedonia e Veriut dhe Serbi)*

## Përmbajtja

|                                    |     |
|------------------------------------|-----|
| <i>Parathënia e botuesve</i> ..... | 4-5 |
|------------------------------------|-----|

### I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

|                                                                                                                                    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b><i>Fernandes de Oliveira kundër Portugalisë</i></b> –A.nr 78103/14<br>Vendimi 31.1.2019 (DHM) .....                             | 12 |
| <b><i>Güzelyurtlu dhe të Tjerë kundër Qipros dhe Turqisë</i></b> - A.nr. 36925/07<br>Vendimi 29.1.2019 (DHM).....                  | 17 |
| <b><i>Ilgiz Khalikov kundër Rusisë</i></b> - A.nr. 48724/15 Vendimi 15.1.2019<br>(Seksioni III) .....                              | 22 |
| <b><i>Gjini kundër Serbisë</i></b> - A.nr. 1128/16 Vendimi 15.1.2019 (Seksioni III) .....                                          | 24 |
| <b><i>Knox kundër Italisë</i></b> - A.nr. 76577/13 Vendimi 24.1.2019 (Seksioni I) .....                                            | 27 |
| <b><i>Rooman kundër Belgjikës</i></b> - A.nr. 18052/11 Vendimi 31.1.2019 (DHM).....                                                | 31 |
| <b><i>Kangers kundër Latonisë</i></b> - A.nr. 35726/10 Vendimi 14.3.2019 (Seksioni V).....                                         | 37 |
| <b><i>Khadija Ismaylova kundër Azerbajxhanit</i></b> - A.nr. 65286/13 dhe 57270/14<br>Vendimi 10.1.2019 (Seksioni V) .....         | 39 |
| <b><i>Cordella dhe të Tjerë kundër Italisë</i></b> - A.nr. 54414/13 dhe 54264/15<br>Vendimi 24.1.2019 [Seksioni I] .....           | 42 |
| <b><i>Beghal kundër Mbretërisë së Bashkuar</i></b> - A.nr. 4755/16 Vendimi 28.2.2019<br>(Seksioni I) .....                         | 46 |
| <b><i>Høiness kundër Norvegjisë</i></b> - A.nr. 43624/14 Vendimi 19.3.2019 (Seksioni II) .....                                     | 50 |
| <b><i>Wunderlich kundër Gjermanisë</i></b> - A.nr. 18925/15 Vendimi 10.1.2019<br>(Seksioni V) .....                                | 52 |
| <b><i>Uzan dhe të Tjerë kundër Turqisë</i></b> - A.nr. 19620/05, 41487/05, 17613/08 et al.<br>Vendimi 5.3.2019 (Seksioni II) ..... | 55 |

## II. AKTGJYKIMET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHTETEVE TË TJERA ME RËNDËSI TË VEÇANTË PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE

|                                                                                                       |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b><i>Stoichkov kundër Bullgarisë</i></b> - A.nr. 9808/02 Vendimi 24.3.2005 (Seksioni I) .....        | 59 |
| <b><i>Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë</i></b> – A.nr. 31679/96 Vendimi 25.1.2000 (Seksioni I) .....  | 61 |
| <b><i>Avilkina dhe të Tjerë kundër Rusisë</i></b> - A.nr. 1585/09 Vendimi 6.6.2013 (Seksioni I) ..... | 64 |
| <b><i>Falzon kundër Maltës</i></b> – A.nr. 45791/13 Vendimi 20.3.2018 (Seksioni IV) .....             | 66 |
| <b><i>Ismayilov kundër Rusisë</i></b> - A.nr. 30352/03 Vendimi 6.11.2008 (Seksioni I) .....           | 69 |

## III. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

|                                                                                                                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b><i>X. Kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> - A. nr. 29683/16, aktgjykim nga data 17.01.2019 .....                                                        | 71 |
| <b><i>Tasev kundër Maqedonisë së Veriut - 9825/13</i></b> Vendimi 16.5.2019 (Seksioni I) .....                                                                 | 73 |
| <b><i>Makraduli kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> – A. nr. 64659/11 dhe 24133/13, aktgjykim nga data 19.07.2018 .....                                    | 76 |
| <b><i>Bashkësia Bektashiane dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> – A. nr. 48044/10; 75722/12 dhe 25176/13, aktgjykim nga data 12.04.2018 ..... | 77 |
| <b><i>Stojanovski dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë</i></b> - A. nr. 14174/09, aktgjykim nga data 07.02.2019 .....                                  | 81 |

## I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 2

#### Neni 2-1

##### Jeta

#### Detyrimet pozitive

Vetëvrasja e një personi të sëmurë mendërisht të shtruar vullnetarisht në spitalin psikiatrik shtetëror për trajtim pas tentimit për vetëvrasje: nuk është shkelje

**Fernandes de Oliveira kundër Portugalisë** – A.nr 78103/14 Vendimi 31.1.2019 (DHM)

**Faktet** – Pas tentimit për kryerjen e vetëvrasjes më 1 prill 2000, A.J., i biri i kërkueses, u shtrua vullnetarisht në një spital psikiatrik shtetëror (*Hospital Psiquiátrico Sobral Cid*, më poshtë “HSC”) për trajtim. Më 27 prill 2000, ai u arratis nga mjediset e spitalit dhe u hodh para trenit. Ai ishte shtruar edhe më parë në të njëjtin spital në disa raste për shkak të çrregullsive të tij mendore, të cilat u përkeqësuan për shkak të varësisë nga alkooli dhe droga. Sipas regjistrave të tij mjekësore, spitali ishte në dijeni të tentativave të tij të mëparshme për vetëvrasje.

Kërkuessa paditi pa sukses HSC-në për kompensim për vdekjen e të birit të saj.

Në një vendim të datës 28 mars 2017 (shih Shënim Informativ 205), një dhomë e gjykatës u shpreh, njëzëri, që nuk ka patur shkelje të aspektit lëndor të Nenit 2. Sipas mendimit të Gjykatës, duke patur parasysh detyrimet pozitive për të marrë masa parandaluese për të mbrojtur individët jeta e të cilëve është në rrezik dhe duke patur parasysh një pacient të sëmurë mendërisht i cili së fundmi kishte tentuar të kryente vetëvrasje dhe kishte tendencën të arratisesh, personeli i spitalit mund të pritej të zbatonte ato garanci që të mos

e lejonin pacientin të largohej nga mjediset e spitalit dhe ta monitoronin atë me një bazë më të rregullt.

Më 18 shtator 2017, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

**Ligji** – Neni 2 (*aspekti lëndor*): Kjo çështje kishte të bënte me pretendime për neglizhencë mjekësore në kontekstin e vetëvrasjes së një pacienti i cili ishte shtruar vullnetarisht në një institucion psikiatrik shtetëror.

(a) *Detyrimi pozitiv për të vendosur një kuadër rregullator* – mungesa e gardheve dhe mureve të sigurisë rreth HSC-së ishte në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor dhe standardet ndërkombëtare që kërkonin krijimin e një regjimi të hapur ku pacientët ruanin të drejtën të lëviznin lirisht. Për më tepër, legjislacioni vendas kishte parashikuar mundësinë e shtrimit të pavullnetshëm në spital, nëse kjo justifikohet nga nevojat specifike të pacientit dhe në këtë mënyrë i kishte dhënë HSC-së mjetet e nevojshme për trajtimin e nevojave mjekësore dhe psikiatrike të A.J.-së.

Për më tepër, personeli në detyrë kishte respektuar procedurën e përgjithshme dhe individuale të monitorimit për pacientët e shtruar vullnetarisht, duke garantuar që pacientët të respektonin oraret specifike dhe të ishin të pranishëm në të gjitha momentet e të ushqyerit dhe të marrjes së medikamenteve. Një procedurë më kufizuese e mbikëqyrjes ishte gjithashtu e disponueshme, që zbatohet në fillim të qëndrimit të pacientit dhe kurdoherë konsiderohet e nevojshme nga mjeku përgjegjës. Së fundmi, në situata e emergjente HSC-së mund të zbatonte forma të tjera kufizuese, duke përfshirë përdorimin e dhomave të izolimit. Procedura ekzistuese e mbikëqyrjes dhe masat e disponueshme kufizuese i kishin dhënë HSC-së mjetet e nevojshme për trajtimin e A.J.-së.

Procedura e mbikëqyrjes e zbatuar për A.J.-në synonte të respektonte jetën private dhe kishte në pajtim me parimin e trajtimit të pacientëve sipas regjimit më pak kufizues të mundshëm. Një regjim më shumë ndërhyrës i mbikëqyrjes mund të ishte kundërshtuar si në kundërshtim me të drejtat e parashikuara në Nenet 3, 5 dhe 8 të Konventës, posaçërisht duke ditur statusin e A.J.-së si pacient i shtruar vullnetarisht.

Në datën që u arratis A.J.-ja procedura e emergjencës, që përbëhej nga vënia në dijeni e mjekut të gatshëm, policisë dhe familjes së pacientit,

ishte zbatuar ndërmjet orës 7 dhe 8 të pasdites. Kjo procedurë ishte e përshtatshme dhe nuk kishte lidhje shkakësore ndërmjet mangësive të pretenduara në procedurat e emergjencës dhe vdekjes së A.J.-së.

Së fundmi, kërkuesja kishte nisur rrugën gjyqësore civile, që, megjithë kohëzgjatjen e tyre, kishte qenë efektive dhe kishte bërë të mundur konstatimin e përgjegjësisë në rastin e vdekjes së A.J.-së.

Për pasojë, në rrethanat e kësaj çështjeje, zbatimi i kuadrit rregullator nuk ishte bërë shkak për shkelje të Nenit 2 të Konventës.

*(b) Detyrimi pozitiv për të marrë masa parandaluese operationale* – Gjykata tashmë ishte shprehur që, në rrethana të mirëpërcaktuara, Neni 2 mund të vendosë një detyrim pozitiv mbi autoritetet për të marrë masa parandaluese operationale për të mbrojtur një individ nga të tjerët ose nga vetja e vet, nëse autoritetet ishin ose duhej të ishin në dijeni të ekzistencës së një risku të vërtetë dhe të menjëhershëm për jetën e një individi. Gjykata konstatoi që autoritetet kishin një detyrë të përgjithshme në lidhje me pacientin e shtruar vullnetarisht në spitalin psikiatrik për të marrë masa të arsyeshme për të mbrojtur atë nga një ris real ose i menjëhershëm vetëvrasjeje.

Gjykata më parë ka marrë parasysh një sërë faktorësh - posaçërisht një historik të problemeve të shëndetit mendor dhe rëndësisë së gjendjes mendore, mendimeve ose kërcënimeve për vetëvrasje dhe shenja të një stresi fizik dhe mendor - me qëllim që të konstatohej nëse autoritetet kishin ditur ose duhej të kishin ditur që jeta e një individi të veçantë i nënshtrohej një risku të vërtetë dhe të menjëhershëm, duke kushtëzuar detyrimin për të marrë masat e përshtatshme parandaluese.

Në këtë rast, HSC-ja kishte kohë që ishte në dijeni të çrregullimeve mendore të A.J.-së dhe që ai kishte risk për vetëvrasje. A.J.-ja kishte patur një historik të gjatë të problemeve të rënda mendore dhe kishte shtruar në HSC-ë vullnetarisht, në 8 raste ndërmjet viteve 1984 dhe 2000. Vetëm qëndrimi i fundit kishte pasuar një vetëvrasje të mbetur në tentativë. Ishte konstatuar nga gjykatat e brendshme që A.J.-ja nuk kishte demonstruar ndonjë shenjë të mendimeve për vetëvrasje gjatë qëndrimit të tij 25-ditor në HS-ë. Nuk kishte patur shenja shqetësuese në sjelljen e A.J.-së në ditët menjëherë para vetëvrasjes së tij.

Megjithëse A.J.-ja ishte vulnerabël, ai kishte patur mundësinë të njihte mirë mjedisin dhe personelin e HSC-së. Ai i ishte nënshtruar një regjimi kufizues, i kufizuar në pavijon i veshur me pizhame, në ditën e parë të qëndrimit të tij dhe në rastet e mëparshme në të shkuarën kur ai ishte shtruar në spital. Kur HSC-ja ishte i mendimit që simptomat po përmirësoheshin, atij i ishte dhënë liria për të lëvizur në mjediset e brendshme dhe të jashtme të spitalit dhe të kthehej në shtëpi për fundjavat së bashku me familjen e tij. Shkalla e konsiderueshme e lirisë së lëvizjes u ishte dhënë pacientëve me qëllim që të rritej përgjegjësia e tyre dhe lehtësuar kthimin e tyre në mjedisin familjar dhe shoqëri. Për më tepër, mjeku psikiatër i A.J.-së ishte i mendimit që trajtimi, që përbëhej nga garantimi që ai të merrte mjekimin e caktuar dhe që ai ta merrte trajtimin vullnetarisht dhe duke vendosur një marrëdhënie besimi me të, ishte i përshtatshëm dhe proporcional në rrethanat përkatëse.

Ndërsa risku i vetëvrasjes nuk mund të përjashtohej në rastin e A.J.-së, HSC-ja ishte përpjekur ti përshtatej riskut që përbëhej nga ndryshimi i gjendjes së ti mendore duke forcuar ose zbutur regjimin e monitorimit në fuqi. Ky vendim i takonte ekipit mjekësor përgjegjës për A.J.-në. Gjykata mori parasysh faktin që, sipas provave me ekspertizë, parandalimi i plotë i vetëvrasjes tek pacientët si A.J.-ja ishte një detyrë e pamundur dhe përfundimi i Gjykatës Administrative ishte që vetëvrasja e A.J.-së nuk ishte e parashikueshme. Për më tepër, Gjykata e shqyrtoi çështjen e riskut në kuptimin e vlerësimit nëse ishte real dhe i menjëhershëm dhe vuri re që detyrimet pozitive që i takonin Shtetit duhej të interpretoheshin në një mënyrë që nuk vendosnin një barrë të pamundur dhe jo-proporcionale mbi autoritetet. Nën dritën e këtyre elementëve, nuk ishte provuar që autoritetet ishin ose duhej të ishin në dijeni që ekzistonte një risk i vërtetë dhe i menjëhershëm për jetën e A.J.-së në ditët para datës 27 prill 2000.

Për pasojë, Gjykata nuk e kishte të nevojshme të vlerësonte nëse autoritetet kishin marrë të gjitha masat që mund të priteshin normalisht të merreshin prej tyre.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (pesëmbëdhjetë vota me dy).

Gjykata gjithashtu nxori përfundimin që kishte patur një shkelje të anës procedurale të nenit 2 pasi gjykimi kishte zgjatur njëmbëdhjetë vjet për dy nivele të juridiksionit.



Neni 41: 10 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih gjithashtu *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [23452/94](#), 28 tetor 1998; *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [27229/95](#), 3 prill 2001, Shënim Informativ 29; *Reynolds kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [2694/08](#), 13 mars 2012, Shënim Informativ 150; *Younger kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), [57420/00](#), 7 janar 2003, Shënim Informativ 49; *Dodov kundër Bullgarisë*, [59548/00](#), 17 janar 2008, Shënim Informativ 104; *De Donder dhe De Clippel kundër Belgjikës*, [8595/06](#), 6 dhjetor 2011, Shënim Informativ 147; *Hiller kundër Austrisë*, [1967/14](#), 22 nëntor 2016; *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë* (DHM), [56080/13](#), 19 dhjetor 2017, Shënim Informativ 213)

## **Neni 1**

### **Juridiksioni i Shteteve**

Juridiksioni i Turqisë në lidhje me Nenin 2, detyrimi procedural që rrjedh pa vrasjeve që kanë ndodhur në pjesën e Qipros të kontrolluar nga Qeveria Qipriote.

## **Neni 2**

### **Neni 2-1**

#### **Hetimi efektiv**

#### **Detyrime pozitive**

Refuzimi i Qipros për të hequr dorë nga juridiksioni penal në favor të gjykatave “TRNC”: nuk ka shkelje

Mosbashkëpunimi i Turqisë me Qipron në hetimin e vrasjeve: shkelje

***Güzelyurtlu dhe të Tjerë kundër Qipros dhe Turqisë*** - A.nr. 36925/07  
Vendimi 29.1.2019 (DHM)

**Fakte** – Kërkuesit ishin të afërm të afërt të tre shtetasve qipriotë me origjinë turko-qipriote, të cilët ishin gjetur të vdekur me plagë të shkaktuar nga armët në zonën e ishullit të kontrolluar nga qeveria qipriote në vitin 2005. Hetimi penal u hap menjëherë nga autoritetet qipriote dhe nga autoritetet turke (duke përfshirë ‘Republikën Turke të Qipros së Veriut’). Megjithatë, megjithëse ishin identifikuar tetë të dyshuar nga autoritetet qipriote dhe u arrestuan dhe u morën në pyetje nga autoritetet TRNC, hetimet u bllokuan dhe dosjet u mbajtën të pezulluara ne pritje të zhvillimeve të reja. Megjithëse hetimet mbetën të hapura, asgjë konkrete nuk u bë pas vitit 2008. Qeveria turke po priste ti dorëzoheshin të gjitha provat në çështje në mënyrë që të gjykonin të dyshuarit, ndërsa hetimet qipriote u bllokuan tërësisht pas kthimit nga Turqia të kërkesave për ekstradim të autoriteteve qipriote. Përpjekjet e ndërmarra nga zyrat e Forcës Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në Qipro (UNFICYP) ishin të pasuksesshme.

Në një vendim të datës 4 prill 2017 (shih Shënim Informativ 206), një Dhomë e Gjykatës u shpreh që ka patur një shkelje procedurale të nenit 2 të Turqia (njëzëri) dhe nga Qipro (pesë vota me dy) për shkak të mosbashkëpunimit të të dy Shteteve në mënyrë efektive me njëri-tjetrin dhe të merrnin të gjitha hapat e arsyeshëm dhe të nevojshëm për të lehtësuar dhe realizuar hetimin e efektshëm në çështje.

Më 18 shtator 2017, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverive të të dy Shteteve të paditur.

**Ligji** – Neni 1 (*juridiksioni territorial në lidhje me Turqinë*): Ka patur shumë pak raste në të cilët Gjykatës i është dashur të shqyrtojë ankimet sipas aspektit procedural të Nenit 2 ku vdekja ka ndodhur sipas një juridiksioni të ndryshëm nga ai i Shtetit në lidhje me të cilin mendohet se ka lindur detyrim procedural. Duket nga praktika gjyqësore e Gjykatës që, në këto rrethana, nëse autoritetet hetimore ose gjyqësore të Shtetit Kontraktues do të kishin filluar hetimin ose gjykimin e tyre penal, kjo do të ishte e mjaftueshme të konstatohej një lidhje juridiksionale për qëllimet e Nenit 1 ndërmjet atij shteti dhe të afërmeve të viktimave që më vonë nisën gjykimin para Gjykatës. Në çështjen e kërkuesve, autoritetet TRNC kishin filluar hetimin e tyre penal për vrasje dhe, në këto rrethana, ekzistonte një ‘lidhje juridiksionale’ ndërmjet

kërkuesve dhe Turqisë, përgjegjësia e të cilës ishte përfshirë sipas Konventës në sajë të veprimeve dhe mosveprimeve të autoriteteve të TRNC-së.

Përveç kësaj, ekzistonin 'tipare të posaçme' në lidhje me situatën në Qipro. Së pari, Turqia konsiderohej nga komuniteti ndërkombëtar në situatë pushtimi të pjesës veriore të Qipros dhe komuniteti ndërkombëtar nuk e njohu TRNC-në si Shtet sipas së drejtës ndërkombëtare. Qiprua Verior ishte nën kontrollin efektiv të Turisë për qëllimet e Konventës. Së dyti, të dyshuarit për vrasje ishin larguar për në TRNC dhe, për pasojë, Qiprua nuk e kishte të mundur të vazhdonte hetimin e vet penal në lidhje me këta të dyshuar dhe në këtë mënyrë të përmbushte detyrimet e veta sipas Konventës.

Duke patur parasysh këta elementë, ku secili prej të dyve do të ishte veçmas i mjaftueshëm për të vendosur një lidhje juridiksionale, u mor i mirëqenë juridiksioni i Turqisë. Çdo konstatim tjetër do të kishte rezultuar në një vakum në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në territorin e Qipros, duke patur riskun e krijimit të një vendi të sigurtë në TRNC për kriminelët që largohen nga territori i kontrolluar nga Qiproja dhe në këtë mënyrë duke penguar zbatimin e ligjeve penale të miratuara nga Qeveria e Qipros për të mbrojtur të drejtën e jetës së qytetarëve të tij dhe, faktikisht, të çdo individi brenda juridiksionit të vet.

**Përfundimi:** brenda juridiksionit të Turqisë (njëzëri).

Neni 2 (*aspekti procedural*): Detyrimi procedural për të hetuar ka lindur në lidhje me të dy shtetet e paditur. Të dy Shtetet kanë ndërmarrë menjëherë një numër të konsiderueshëm hapash dhe nuk në lidhje me këto hetime nuk është ngritur asnjë pikëpyetje. Thelbi i problemit është ekzistenca dhe objekti i detyrimit për të bashkëpunuar si një komponent i detyrimit procedural sipas Neni 2 të Konventës.

Neni 2 mund u kërkojë të dy Shteteve një detyrim me dy kahje për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, duke nënkuptuar në të njëjtën kohë një detyrim për të kërkuar asistencë dhe një detyrim për të dhënë asistencë. Një detyrim i tillë ishte në pajtim me mbrojtjen efektive të së drejtës së jetës sipas garantimit nga Neni 2. Shtetet e interesuar duhej të kishin marrë të gjitha hapat e arsyeshëm proceduralë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, duke shteruar në mirëbesim mundësitë e ofruara sipas instrumenteve

të zbatueshme ndërkombëtare për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimin në çështjet penale.

Detyrimi procedural për të bashkëpunuar sipas nenit 2 duhej të interpretohej nën dritën e traktateve ndërkombëtare ose marrëveshjeve të zbatueshme ndërmjet Shteteve Kontraktues të interesuar, duke ndjekur, për sa të jetë e mundur, një zbatim të kombinuar dhe harmonik të Konventës dhe këtyre instrumenteve, që nuk duhet të rezultojnë në konflikt ose kundërshtim ndërmjet tyre. Në këtë kontekst, detyrimi procedural për të bashkëpunuar do të shkelej vetëm në lidhje me një Shtet që kërkohej bashkëpunim nëse ai nuk ka zbatuar mekanizmat e duhur për bashkëpunim sipas traktateve përkatëse ndërkombëtare; dhe në lidhje me Shtetin e kërkuar, nëse ai nuk është përgjigjur rregullisht ose nuk ka qenë në gjendje të tregojë një shkak të ligjshëm për refuzimin e bashkëpunimit të kërkuar sipas këtyre instrumenteve.

Një tipar i posaçëm i çështjes së kërkuesve ishte që mungesa e pretenduar e bashkëpunimit kishte të bënte me një njësi *de facto* të ngritur në territorin e njohur ndërkombëtarisht të Qipros, por që ishte nën kontrollin efektiv të Turqisë për qëllimet e Konventës. Meqenëse të dy Shtetet e paditur nuk kishin marrëdhënie diplomatike, traktatet ndërkombëtare tek të cilët të dy Shtetet ishin palë, nuk mund të ishin kuadri i vetëm i referencës në përcaktimin nëse të dy shtetet kishin përdorur të gjitha mundësitë e ofruar atyre për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin. Në mungesë të marrëdhënieve diplomatike formale, mjetet e formalizuara të bashkëpunimit kishin shumë mundësi të dështonin dhe Shteteve mund t'u duhej të përdorni kanale të tjera informale ose jo të drejtpërdrejta të bashkëpunimit, për shembull nëpërmjet Shteteve të tretë ose organizatave ndërkombëtare. Duke patur parasysh këtë, Gjykata duhej të konstatonte nëse, në situatë të tilla, Shtetet përkatës kishin përdorur të gjitha mjetet normalisht të disponueshme për ta për të kërkuar dhe ofruar bashkëpunimin e nevojshëm për efektivitetin e hetimit dhe gjykimin si një i tërë.

#### (a) Qiprua

(i) Nëse Qiprua kishte përdorur të gjitha mjetet e arsyeshme dhe të disponueshme me qëllim që të kërkonte dorëzimin/ekstradimin e të dyshuarve nga Turqia – Në vijim të identifikimit të të dyshuarve të mundshëm në fazat e hershme të hetimit, autoritetet qipriote kishin shpallur kërkesat për kërkim

ndërkombëtar tek Interpoli me qëllim që të lokalizoheshin të dyshuarit dhe të arrestoheshin ata me qëllim ekstradimin e tyre. Këto kërkesa për kërkim ndërkombëtar ishin publikuar nga Interpoli. Zyra qipriote e Interpolit i kishte dërguar gjithashtu e-mail Ministrisë Turke të Punëve të Brendshme duke u shprehur që ajo po kërkonte të dyshuarit dhe duke kërkuar që ata të arrestoheshin nëse ata futeshin në Turqi.

Qiprua u përpoq të negocionte dorëzimi e të dyshuarve nga TRNC-ja nëpërmjet UNFICYP-it qysh në fazat e hershme të hetimit. Megjithatë, ishte shumë e qartë qysh në fillim që as autoritetet turke dhe as ato të TRNC-së nuk e kishin ndër mend dorëzimin e të dyshuarve. Në këto rrethana, Qiprua nuk mund të kritikohej për përpjekjen për realizimin e të dyshuarve nëpërmjet UNFICYP-it dhe, vetëm pasi këto përpjekje faktikisht dështuan, i paraqitjen Turqisë të kërkesave për ekstradim.

Kërkesat për ekstradim iu paraqitën Turqisë nëpërmjet ambasadës turke në Athinë. Duke ditur mungesën e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Qipros dhe Turqisë, dorëzimi i kërkesave nëpërmjet personelit të ambasadave të tyre përkatëse në Athinë mund të pranohet në rrethana të caktuara të çështjes si kanali i vetëm i disponueshëm për Qipron.

(ii) *Nëse Qiprua ishte nën detyrimin e dhënies së të gjitha provave autoriteteve të TRNC-së ose Turqisë* – Çështja e kërkuesve duhej të dallohej nga çështjet e mëparshme në të cilat Gjykata ka pranuar vlefshmërisë, për qëllimet e Konventës, të mjeteve ligjore të përcaktuara ose masave të marra nga autoritetet e TRNC-së në lidhje me banorët e TRNC-së ose personat që preken nga veprimet e tyre. Në këto raste, Gjykata kishte njohur vlefshmërinë e këtyre mjeteve dhe veprimeve në masën e nevojshme që Turqia të ishte në gjendje të siguronte të gjitha të drejtat e Konventës në Qipron verior dhe për të korrigjuar çdo të metë që i vishej asaj.

Në rastin e kërkuesve, çështja që duhej zgjidhur ishte nëse Qipros i ishte kërkuar tu jepte të gjitha provat nga dosja hetimore e tij autoriteteve të TRNC-së, që ishin duke zhvilluar një hetim paralel në vrasje në pajtim me ligjin e tyre të brendshëm. Qiprua ishte i gatshëm ti jepte të gjitha provat UNFICYP-it në mënyrë që ky i fundit të shihte nëse haptazi ka një çështje ndaj të dyshuarve, përkundërt angazhimit të autoriteteve të TRNC-së që ata do ti dorëzonin të dyshuarit Qipros në një rast të tillë. Meqenëse nuk ka patur një angazhim të tillë nga autoritetet e TRNC-së, Qiprua refuzoi të

dorëzonte prova të tjera. Dorëzimi i të gjithë dosjes hetimore tek TRNC-ja duke patur parasysh mundësinë që provat të përdorëshin për të gjykuar të dyshuarit atje dhe pa asnjë garanci që ata do të dorëzoheshin tek autoritetet Qipriote, do të shkonte tej bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve policore dhe të ndjekjes penale. Kjo në thelb do të thoshte transferim i çështjes penale nga gjykatat e Qipros tek ato të TRNC-së dhe Qiprua do të hiqte dorë nga juridiksioni i vet penal në lidhje me një vrasje që ishte bërë në territorin e kontrolluar prej tij në favor të gjykatave të një njësie të panjohur të ngritur brenda territorit të vet. Faktikisht ushtrimi i juridiksionit penal ishte një prej tipareve kryesore të sovranitetit të një Shteti. Në një situatë të tillë specifike, nuk do të ishte e paarsyeshme refuzimi i heqjes dorë nga juridiksioni i vet penal në favor të gjykatave të TRNC-së.

(iii) *Nëse Qiprua ka qenë nën detyrimin për tu angazhuar në forma të tjera bashkëpunimi siç sugjerohej nga UNFICYP-i* – Në kontekstin e përpjekjeve të ndërmjetësimit të ndërmarra nga UNFICYP-i, u sugjeruan shumë forma bashkëpunimi me qëllim që të gjendej një zgjidhje kompromisi ndërmjet autoriteteve të Qipros dhe TRNC-së. Megjithatë, këto forma bashkëpunimi, ne vetvete, nuk mund të kishin lehtësuar ndjekjen penale dhe gjykimin e të dyshuarve. Nuk u vërtetua që këto alternativa, veçanërisht mundësia e realizimit të një gjykimi ad hoc në një vend neutral do të kishte një bazë të shëndoshë në masë të mjaftueshme në të drejtën e brendshme ose ndërkombëtare. Në këto rrethana, Qipros nuk iu kërkuar të angazhohej në to sipas Nenit 2.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (pesëmbëdhjetë vota me dy).

#### (b) *Turqia*

Turqia kishte injoruar kërkesat për ekstradim dhe i kishte kthyer ato pa përgjigje. Autoritetet turke do të priteshin të bënin të ditur nëse ato konsideronin që ekstradimi nuk ishte i pranueshëm sipas legjislacionit të tyre ose sipas Konventa Europiane për Ekstradimin.. Konventa e Ekstradimit vendoste detyrimin mbi Shtetin e kërkuar të informonte Shtetin kërkuar në lidhje me vendimin e vet për sa i takon ekstradimit dhe në rast refuzimit të jepte arsyet për një vendim të tillë. Detyrimi për të bashkëpunuar sipas Nenit 2 duhej të lexohej nën dritën e atyre dispozitave dhe duhej të përbënte një detyrim për Shtetin për të shqyrtuar dhe dhënë një përgjigje të arsyetuar në lidhje me çdo kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Kontraktues në

lidhje me të dyshuarit e kërkuar për vrasje me dashje ose vrasje të tjera të paligjshme që njiheshin se ishin në territorin ose juridiksionin e vet.

Turqia nuk kishte bërë as përpjekjet minimale të kërkuara në rrethanat e çështjes dhe në këtë mënyrë nuk kishte respektuar detyrimin e vet për të bashkëpunuar me Qipron për qëllimet e një hetimi efektiv në vrasjen e të afërmeve të kërkuarve.

**Përfundim:** shkelje në rastin e Turqisë (njëzëri).

Neni 41; 8 500 EURO për çdo kërkuar në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih gjithashtu *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, [25965/04](#), 7 janar 2010, *Shënim Informativ 126*; *Al-Skeini dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (DHM), [55721/07](#), 7 korrik 2011, *Shënim Informativ 143*; *Markovic dhe të tjerë kundër Italisë* (DHM), [1398/03](#), 14 dhjetor 2006, *Shënim Informativ 92*; *Janowiec dhe të tjerë kundër Rusisë* (DHM), [55508/07](#) dhe [29520/09](#), 21 tetor 2013, *Shënim Informativ 167*; *Cyprus kundër Turqisë*, [25781/94](#), 10 May 2001; *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* (DHM), [24014/05](#), 14 April 2015, *Shënim Informativ 184*; *Demopoulos dhe të tjerë kundër Turqisë* (dec.) (DHM), [46113/99](#) et al., 1 mars 2010, *Shënim Informativ 128*)

## Neni 3

### Trajtimi Çnjerëzor

Plagosje e të ndaluarit për shkak të kushteve të papërshtatshme të transportit: shkelje

***Ilgiz Khalikov kundër Rusisë*** - A.nr. 48724/15 Vendimi 15.1.2019 (Seksioni III)

**Fakte** – Kërkuar dhe tetë të ndaluar të tjerë u transportuan në një automjet burgu me kapacitet prej maksimalisht shtatë të ndaluar, me tre sedilje për punonjësit e eskortës. Duke qenë ish punonjës policie, kërkuar u vendos pranë punonjësve të eskortës. Në një moment të caktuar, tre të ndaluar tentuan të arratisen dhe një prej tyre kapi armën e një punonjësi policie. Gjatë

të shtënave që pasuan, kërkuesi u plagos në këmbë nga një plumb qorr. Në vijim ai bëri një ankim për shkelje të rëndë të rregullores për transferimin e të burgosurve. Pas një ‘verifikimi para-hetimor’, u mor një vendim, jo më vonë se një muaj në vijim, duke refuzuar fillimin e çështjes penale.

### **Ligji – Neni 3**

(a) *Aspekti procedural* – Në shumë raste të mëparshme kundër Federatës Ruse, Gjykata ka theksuar defektet strukturore të formatit të ‘verifikimit para-hetimor’. Në momentin e përballjes me një pretendim të besueshëm të keqtrajtimit, autoritetet kishin detyrimin për të hapur çështje penale dhe zhvilluar një hetim. Në vend të kësaj, verifikimi në këtë rast ishte i vonuar dhe i pamjaftueshëm në objekt dhe nuk bënte përpjekje serioze për të evidentuar të gjitha rrethanat e incidentit ose për të caktuar përgjegjësinë për të shtënë që kishte plagosur kërkuesin. Refuzimi për të hapur çështje penale në pretendimet e besueshme të kërkuesit për mosruajtjen e integritetit fizik, për të cilën autoritetet u vunë menjëherë në dijeni, u bë shkak për mos-fillimin e një hetimit të efektshëm.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

(b) *Aspekti lëndor* – Në lidhje me faktin nëse Shteti duhet të bëhet përgjegjës për plagosjen e kërkuesit, Gjykata vuri re që kërkuesi ishte viktimë në një të shtënë rastësore që pasoi një dështim për arratisjen nga burgu, në të cilën ai nuk kishte asnjë rol. Ishte e qartë që ai ishte qëlluar në këmbë rastësisht dhe jo me qëllim dhe asgjë nuk tregonte që dikush e kishte kërkuesin si objekt apo donte ta dëmtonte atë.

Nga ana tjetër, megjithëse plagosja e kërkuesit ishte aksidentale, prania e tij në zonën e pasigurtë të automjetit të burgut ishte rezultat i vendimit të punonjësve të eskortës për të transportuar më shumë të ndaluar nga sa ishte kapaciteti i automjetit të burgut, në shkelje të rregullores së përgjithshme. Për pasojë, nuk kishte qeli të veçantë për kërkuesin dhe ai duhej të udhëtonte me rojat. Një veprim i tillë ishte në kundërshtim me rregulloren specifike në lidhje me vendosjen e kategorive tepër vulnerabël të të burgosurve, si ish-punonjësit e zbatimit të ligjit, si kërkuesi, në një qeli të veçantë gjatë transportit.



Rregulloret për transferimin e të burgosurve ishin të destinuara me objektivin e parandalimit të incidenteve në lidhje me sigurinë si kjo që është në shqyrtim; ato kufizonin numrin e të burgosurve që mund të transportoheshin së bashku për të ulur riskun e një përpjekjeje të organizuar nga ana e tyre për të vënë poshtë punonjësit e eskortës. Ato gjithashtu synonin e shmangies së dhunës ndërmjet të burgosurve duke kërkuar ndarjen e të ndaluarve që janë vulnerabël.

Në këtë rast, punonjësit e eskortës nuk i kushtuan rëndësi risqeve të sigurisë që shkaktohej nga transporti i më shumë të burgosurve nga sa lejohej nga kapaciteti i automjetit. Pavarësisht nëse ata u përpoqën të kursenin karburant ose një udhëtim të dytë, ata vepruan duke mos respektuar rregulloret që ishin në fuqi për të mbrojtur mirëqenien dhe integritetin fizik të të ndaluarve gjatë transportit. Në këto rrethana, Shteti duhej të mbahej përgjegjës për mos-dhënien e mbrojtjes së përshtatshme për integritetin fizik të kërkuar gjatë transportit.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Neni 41: 20 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

### Neni 3

#### Hetimi efektiv

#### Detyrime pozitive

Autorët nuk janë të liruar nga detyrimi për të hetuar dhunën ndërmjet të burgosurve megjithë mungesën e denoncimit: shkelje

**Gjini kundër Serbisë** - A.nr. 1128/16 Vendimi 15.1.2019 (Seksioni III)

**Faktet** – Kërkuar ishte arrestuar në lidhje me dyshimin për të paguar një detyrim në një pikë të kalimit kufitar me një kartëmonedhë të falsifikuar prej dhjetë eurosh. Ai u ndalua në Burgun Sremska Mitrovica në pritje të

hetimit. Kartëmonedha më vonë doli të ishte jo-fallso dhe procesi ndaj tij u pushua.

Kërkuesi u ankua që ndërsa ai ishte i ndaluar, ai ishte keq-trajtuar nga shokët e qelisë, të cilët e kishin kërcënuar që do të inskenonin vetë-vrasjen e tij nëse ai do ti tregonte ndokujt për atë që kishte ndodhur. Disa ditë pas fillimit të ndalimit të tij, avokati i kërkuesit njoftoi ndryshime në sjelljen e tij dhe nxitu autoritetet e burgut për ta kaluar në një qeli tjetër. Kërkuesi u transferua dhe keqtrajtimi pushoi. Në gjyqin civil pasues që u fillua nga kërkuesi pas lirimit të tij nga burgu, u vërtetua që ai kishte pësuar stres post-traumatik gjatë dhe pas ndalimit të tij dhe iu dha kompensim.

### ***Ligji – Neni 3***

*(a) detyrimi i shtetit për të parandaluar keqtrajtimin ose për zbutur dëmin –* Mungesa e një përfshirjeje të drejtpërdrejtë në aktet e dhunës që kanë arritur nivelin e ashpërsisë që aktivizojnë Nenin 3 nuk e lirojnë Shtetin nga detyrimet e tij sipas kësaj dispozite. Shteti ishte i detyruar të paktën të ofronte mbrojtje efektive për personat brenda juridiksionin e tij, duke përfshirë hapat e arsyeshëm për të parandaluar keq-trajtimin për të cilin autoritetet shtetërore kishin ose duhej të kishin dijeni.

Duke marrë parasysh konstatimet në gjykimin e brendshëm civil, Gjykata pranoi si të provuar që kërkuesi ishte pësuar keq-trajtim në duart e shokëve të tij të qelisë. Sipas mendimit të Qeverisë, meqenëse nuk ishte bërë asnjë ankim nga kërkuesi, autoritetet e burgut nuk mund të priteshin ta mbronin atë. Megjithatë, Komiteti Europian për Parandalimin e torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) kishte raportuar dhunë ndërmjet të burgosurve në burgun në fjalë dhe e kishte vënë në dukje vazhdimisht si një problem serioz, si para ashtu edhe pas ngjarjeve të çështjes së kërkuesit. ai kishte vënë në dukje një numër të madh çështjesh në lidhje me dhunën ndërmjet të burgosurve dhe kishte vënë në dukje që asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë nga autoritetet e burgut ose të Shtetit për të korrigjuar një sjellje të tillë ose për ta ulur atë.

Personeli i burgut duhet të ketë vënë re keqtrajtimin e kërkuesit dhe nuk kishte mundur të vepronte ndaj asnjë shenje dhune; ata më tej nuk kishin mundur të siguronin një mjedis të sigurt për kërkuesin dhe për të zbuluar, parandaluar ose monitoruar dhunën që ai i ishte nënshtruar.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

(b) *Mos-hetimi* – Pranohej që nuk ishte zhvilluar asnjë hetim në lidhje me pretendimet e kërkuarit për keqtrajtimin e tij nga shokët e qelisë në burg. Kështu, ishte e pamundur për Gjykatën të provojë nëse hetimi për pretendimet e kërkuarit kishte qenë efektiv. Pyetja ishte nëse mos-paraqitja nga kërkuari i një kallëzimi penal i kishte penguar autoritetet shtetërore të zhvillonin një hetim ose i kishte liruar ata nga detyrimi i përgjithshëm për ta bërë këtë.

Autoritetet ishin ose duhej të ishin në dijeni në lidhje me keq-trajtimin e kërkuarit. Nuk kishte asnjë element formal apo faktik që do të pengonte hetimin. Nuk kishte asgjë në ligjin e brendshëm që do të pengonte autoritetet e burgut ose të tjera të reagonin apo të fillonin një hetim penal. Përkundrazi, kuadri ligjor serb ishte i qartë në vendosjen e detyrimit mbi të gjitha autoritetet publike për të raportuar veprat penale që i nënshtrohen ndjekjes penale për të cilat kanë ardhur në dijeni.

Mungesa e një kallëzimi penal nga kërkuari nuk e pengonte prokurorin publik të fillonte procedimin penalisht të çështjes dhe nuk i pengonte autoritetet e tjera publike nga informimi i prokurorit publik në lidhje me pretendimet e keqtrajtimin.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Neni 41: 25,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Gäffen kundër Gjermanisë* (DHM), [22978/05](#), 1 qershor 2010, [Shënim Informativ 131](#); dhe *Premiun kundër Rusisë*, [44973/04](#), 10 shkurt 2011, [Shënim Informativ 138](#). Shih gjithashtu the [Raporte të CPT-së](#) mbi vizitat në Serbi dhe veçanërisht dokumentin [CPT/Inf \(2006\) 18](#))

### Neni 3

#### Hetimi efektiv

Moshetimi i pretendimeve për keqtrajtim nga policia gjatë marrjes në pyetje të një personi në gjendje shoku: shkelje

## Neni 6

### Neni 6-3- c

#### Mbrojtja nëpërmjet asistencës ligjore

Përdorimi si provë i akuzës keqdashëse të bërë në polici nga një person në gjendje shoku, pa akses tek një avokat: *shkelje*

### Neni 6-3-e

#### Asistenca falas e një përkthyesi

Interpretja që ka vepruar si ndërmjetëse dhe me një qëndrim miqësor gjatë marrjes në pyetje të një personi në gjendje shoku: *shkelje*

***Knox kundër Italisë*** - A.nr. 76577/13 Vendimi 24.1.2019 (Seksioni I)

***Fakte*** – Në momentin e ngjarjeve, Zj Knox, një studente amerikane 20-vjeçare, ishte në Itali për rreth dy muaj. Ajo kishte gjetur një punë të përkohshme në një bar që menaxhohej nga D.L. Pas zbulimit të trupit të një vajze që jetonte në të njëjtin apartament si dhe kërkuesja, e cila ishte e pranishme në këto mjedise së bashku me shokun e saj, ata u intervistuan të dy nga policia dhe u monitoruan bisedat e tyre telefonike.

Më 6 nëntor 2007, ora 1 45 e paradites, kërkuesja u intervistua nga tre punonjës policie dhe A.D., e cila ishte thirrur si interprete. Ndërmjet të tjerash ajo deklaroi që krimet i kishte kryer D.L. Prokurori publik pastaj e intervistoi kërkuesen në orën 5 45 të paradites, ku të pranishëm ishin A.D. dhe disa punonjës policie. Kërkuesja nuk ishte e asistuar nga një avokat gjatë intervistës. Në orën 8 30 të paradites, kërkuesja, shoku i saj dhe D.L. u arrestuan formalisht me akuzën e sulmit seksual dhe vrasje me dashje. Pasi dha një alibi, D.L. më vonë u lirua.

Rreth orës 1 të pasdites, dhe gjatë gjithë procedimit, kërkuesja u shpreh për gjendjen e saj të shokut dhe konfuzionit gjatë intervistës së saj kriminalizuese nën presionin e policisë dhe ajo e tërhoqi akuzën e saj ndaj

D.L. Megjithatë, ajo u akuzua formalisht më 14 maj 2008 për shkak të kallëzimit keqdashës.

Pas një seance më 13 mars 2009, në të cilën kërkuesja pretendoi se ajo ishte keqtrajtuar gjatë intervistës së saj të datës 6 nëntor 2007 dhe u ankua në lidhje me sjelljen e interpretes A.D., mbrojtja e saj kërkoi transmetimin e dokumenteve tek zyra e prokurorit publik por nuk ndodhi asgjë. Në ngarkim të kërkueses u nisën çështje të tjera penale për kallëzim të rremë të punonjësve të policisë dhe prokurorit që e kishin marrë në pyetje atë më 6 nëntor 2007.

Në shtator 2015, Gjykata e Kasacionit e shpalli kërkuesen të pafajshme në lidhje me akuzat e vrasjes me dashje dhe sulmit seksual dhe vuri re që fajësimi i saj dhe dënimi prej tre vitesh burgim për kallëzim me keqdashje ndaj D.L. kishin marrë formë të prerë. Kërkuesja mori pafajësi edhe për akuzën e kallëzimit të rremë të punonjësve të policisë dhe prokurorit.

### ***Ligji***

Neni 3 (*aspekti procedural*): Më 6 nëntor 2007, disa orë pas bërjes së deklarimeve inkriminuese në lidhje me D.L., dhe gjatë gjithë procedimit, kërkuesja kishte shpjeguar qartësisht që ajo ishte në një gjendje ekstreme shoku dhe konfuzioni dhe që policia e kishte vënë atë nën presion. Gjykata e Apelit, në vendimin e saj të datës 3 tetor 2011, kishte nxjerrë përfundimin që kërkuesja në fakt ishte vendosur në një shkallë të konsiderueshme mundimi, duke e vendosur atë në një situatë të padurueshme psikologjike nga e cila ajo ishte përpjekur të dilte duke inkriminuar D.L.-në.

Përveç kësaj, interpretja kishte vepruar më shumë si ‘ndërmjetëse’, edhe pse ajo nuk e kishte në nevojshme të shkonte tej detyrës së saj të interpretimit. Një nga punonjësit e policisë e kishte përqafuar dhe fërkuar kërkuesen dhe i kishte shtrënguar dorën, duke vepruar kështu në mënyrë të papërshtatshme, veçanërisht në kontekstin kur ajo kishte bërë kallëzime që më vonë u karakterizuan si keqdashëse dhe që kishin rezultuar në dënimin e saj.

Sjellja e sipër-përmendur, që hidhte dritë mbi kushtet e përgjithshme në të cilat ishte intervistuar kërkuesja, duhej të kishte alarmuar autoritetet e brendshme për mundësinë e cenimit të dinjitetit dhe aftësisë së saj për vetë-vendosje.

Me gjithë ankesat e saj të përsëritura, trajtimi për të cilin ishte bërë ankesë nuk ishte bërë shkak për ndonjë hetim që do të hidhte dritë mbi faktet dhe mbi ndonjë përgjegjësi. Posaçërisht, kërkesa e avokatit e datës 13 mars 2009, për transmetimin e dokumenteve tek prokurori publik kishte mbetur pa përgjigje. Për më tepër, procedimi penal në ngarkim të kërkuësës për bërjen e kallëzimit keqdashës kundër autoriteteve - që në fakt kishte sjellë pafajësinë e saj, pasi nuk kishte prova që tregimi i saj për atë që kishte ndodhur të ishte i pasaktë - nuk mund të përbënte një hetim të efektshëm për ankimet e kërkuësës.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Ligji – Neni 6 par 1 dhe 3 (c)

(a) *Zbatueshmëria e Nenit 6* – Gjykata përsëriti që një ‘akuzë penale’ ekzistonte nga momenti që një individ njoftohej zyrtarisht nga autoriteti kompetent për një pretendim që ai ka kryer një vepër penale ose nga momenti në të cilin situata e tij është ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si rezultat i një dyshimi ndaj tij. Kërkesja mund të konsiderohet si e dyshuar nga momenti që ajo ka bërë deklarinimet e saj para prokurorit publik, në orën 5 45 të paradites, më 6 nëntor 2007. Kështu, jo më vonë se ora 5 45 e paradites, në ngarkim të saj ishte një akuzë brenda kuptimit të Konventës.

(b) *Nëse ka patur shkaqe detyruese për të justifikuar kufizimin e së drejtës së saj të aksesit tek një avokat* – Qeveria ishte mbështetur në interpretimin e praktikës gjyqësore të brendshme për të vënë në dukje që deklarinimet e kundërshtuara të datës 6 nëntor 2007, megjithëse nuk ishte i pranishëm asnjë avokat, mund të përdoreshin si provë, pasi ato në vetvete përbënin vepër penale. Megjithatë, Gjykata vuri re që ky interpretim ishte i përgjithshëm në objekt dhe Qeveria nuk kishte mundur të provonte që ka patur rrethana të posaçme në këtë çështje për të justifikuar kufizimet mbi të drejtën e kërkuësës. Kështu nuk ka patur shkak detyrues të përshtatshëm për të justifikuar kufizimet mbi aksesin e saj tek një avokat.

(c) *Drejtësia e procedimit në tërësi* – Disa orë pas intervistës së datës 6 nëntor 2007, kërkesja, e cila ishte e pambrojtur si e huaj dhe si vajzë 20-vjeçare që nuk kishte shumë kohë që ishte në Itali dhe që nuk fliste italisht, i kishte tërhequr deklarinimet e saj. Megjithatë, gjashtë muaj më vonë, më 14 maj 2008, ajo u akuzua për kallëzim keqdashës.

Deklarimet e diskutuara ishin marrë në kontekstin e një presioni të lartë psikologjik, që nuk ishte hetuar. Dhe këto deklarime përbënin në vetvete veprën penale për të cilën ajo ishte akuzuar dhe në këtë mënyrë prova e vërtetë mbi bazën e së cilës ajo ishte dënuar për bërjen e kallëzimit keqdashës. Së fundmi, protokoll i intervistës së kërkueses e orës 5 45 e paradites, nuk tregonte që ajo ishte vënë në dijeni në lidhje me të drejtat e saj procedurale.

Për pasojë, kufizimi i aksesit të kërkueses tek asistenca ligjore gjatë intervistës së saj të datës 6 nëntor 2007, ora 5 45 e paradites, kishte tentuar në mënyrë të pakthyeshme drejtësinë e procedimit.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Ligji – Neni 6, par 1 dhe 3 (e) Fakti që interpretja A.D., kishte luajtur rolin e një ndërmjetëseje, duke demonstruar një qëndrim mirëdashës, ndërsa kërkuesja, duke qenë e akuzuar për një vepër penale, po bënte deklaratimet e saj, kishte shkuar tej detyrave që priteshin nga një interpret. Megjithatë, autoritetet nuk e kishin vlerësuar sjelljen e A.D.-së, për të konsideruar nëse asistenca e saj si interprete kishte qenë në pajtim me garancitë e nenit 6, par 1 dhe 3(e) të Konventës, ose për të konsideruar nëse kjo sjellje kishte patur një ndikim në rezultatin e procedimit penal në ngarkim të kërkueses. Përveç kësaj, protokoll i përkatës i policisë nuk përmendte shkëmbimet ndërmjet kërkueses dhe A.D.-së gjatë intervistës së datës 6 nëntor 2007.

Ky mosveprim fillestar kishte patur pasoja mbi të drejtat e tjera, që ishin të ndara, por të lidhura ngushtë me të drejtën në fjalë dhe kishte minuar të gjithë drejtësinë e e procedimit në tërësi.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi gjithashtu që nuk kishte shkelje të Nenit 3 në aspektin e tij lëndor, pasi ka patur prova të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundimin që kërkuesja i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues për të cilin ajo u ankua.

Neni 41: 10,400 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Salduz kundër Turqisë* (DHM), [36391/02](#), 27 nëntor 2008, *Shënim Informativ 113*; *Gäfgen kundër Gjermanisë* (DHM), [22978/05](#), 1 qershor 2010, *Shënim Informativ 131*; *Kaçiu dhe Kotorri kundër*

*Shqipërisë, 33192/07 dhe 33194/07, 25 qershor 2013; Baytar kundër Turqisë, 45440/04, 14 tetor 2014, Shënim Informativ 178; Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (DHM), 50541/08 et al., 13 shtator 2016, Shënim Informativ 199; Beuze v. Belgium (DHM), 71409/10, 9 nëntor 2018, Shënim Informativ 223; dhe Raportin Faktik mbi Arresti nga policia dhe asitenca e një avokati)*

## Neni 5

### Neni 5-1-e

#### Personat me çrregullime mendore

Detyrimi i mjeteve për kapërcimin e pengesës gjyqësore për trajtimin e çrregullimeve mendore që pësohen nga një individ në ndalim të detyruar : shkelje; nuk ka shkelje

## Neni 3

#### Trajtimi poshtërues

Detyrimi i mjeteve për kapërcimin e pengesës gjyqësore për trajtimin e çrregullimeve mendore që pësohen nga një individ në ndalim të detyruar : shkelje; nuk ka shkelje

**Rooman kundër Belgjikës** - A.nr. 18052/11 Vendimi 31.1.2019 (DHM)

**Faktet** – Kërkuesi i cili ka pësuar një çrregullim të rëndë mendor që e ka bërë atë të paaftë për të kontrolluar veprimet e tij, ishte mbajtur në ndalim të detyruar qysh nga viti 2004 në një institucion të specializuar ku nuk kishte personel që të fliste gjermanisht, megjithëse ai vetë fliste vetëm gjermanisht (një prej tre gjuhëve zyrtare në Belgjikë). Bordi i mbrojtjes sociale vuri në dukje në disa raste që vështirësitë në komunikim kishin efektin e provimit të kërkuesit nga marrja e çdo trajtimi për çrregullimet e veta mendore (që, mi të gjitha, e bënë të mundur të parashikohej lirimi i tij) por rekomandimet



u respektuan nga autoritetet vetëm pjesërisht ose me vonesë. Autoritetet përkatëse gjyqësore arritën konstatime të ngjashme në vitin 2014.

Me vendim të datës 18 korrik 2017 (shih [Shënim Informativ 209](#)), një Dhomë e Gjykatës kishte nxjerrë përfundimin, njëzëri, që kishte shkelje të Nenit 3, për shkak të mosdhënies së trajtimit të përshtatshëm për mbi tridhjetë vjet, dhe, gjashtë vota me një, që nuk kishte shkelje të Nenit 5, par 1, duke u shprehur që pengesa për dhënien e trajtimit të përshtatshëm nuk lidhej me natyrën faktike të institucionit. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuarit.

Qysh nga gushti i vitit 2017, ishin marrë një sërë masash për të asistuar kërkuarin: takime mujore me një psikolog; disponibiliteti i konfirmuar i një psikiatri gjermanisht-folës; përfshirja e një interpreti për takimet mujore me mjekun e përgjithshëm. Megjithatë, kërkuari nuk ishte shumë e hapur (ai nuk e shfrytëzoi mundësinë konsultimeve psikiatrike dhe refuzoi të lejonte psikologët e jashtëm të dëgjonin konstatimet e saj me ekipin e brendshëm të mirëqenies dhe psikologjike).

Në vitin 2016, hyri në fuqi një ligj i ri për ndalimin e detyruar; ai theksonte rrugën e kujdesit që duhej të ofrohej për personat në ndalim të detyruar.

**Ligji** – Neni 3 (*aspekti lëndor*): Thjesht elementi gjuhësor mund të dilte të ishte vendimtar në lidhje me administrimin (disponibilitetin) e trajtimit të përshtatshëm, por vetëm nëse faktorët e tjerë nuk e bënin të mundur kompensimin e mungesës së komunikimit; veçanërisht, trajtimi i nënshtrohej bashkëpunimit nga individit përkatës.

– *Periudha nga 2004 deri 2017* – Këtu, Dhoma e Madhe ritheksoi në thelb konstatimet e Dhomës dhe nuk identifikoi faktorë kompensues. Për të justifikuar mungesën e trajtimit psiko-terapik, autoritetet kishin vënë re që, nga njëra anë, rrezikshmëria e kërkuarit e përjashtonte vendosjen e tij në një institucion më pak të sigurt gjermanisht-folës, dhe, nga ana tjetër, që në institucionin në fjalë nuk kishte personel gjermanisht-folës, pa eksploruar mundësitë e tjera.

**Përfundimi:** shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një)

– *Periudha nga gushti 2017* – Së pari, autoritetet kishin treguar një vullnet të vërtetë për të ndrequr situatën pas vendimit të Dhomës duke marrë

masa konkrete, të cilat *a priori* përputheshin me konceptin e ‘trajtimit të përshtatshëm’.

Së dyti, kërkuesi nuk kishte bashkëpunuar si duhet dhe nuk ishte i hapur për trajtimin r propozuar (që ishte një psikiatër i jashtëm, i cili ishte i ‘disponueshëm’ për të). Ndërsa grafiku terapik ishte natyrisht për të ardhur keq, pasi mbeti situata që kërkuesi as nuk kishte kërkuar të përfitonte nga konsultimi i propozuar me psikiatrin. Dihet që, meqenëse kërkuesi ishte një individ vulnerabël, bashkëpunimi i tij ishte vetëm një faktor që duhej të merrej parasysh në vlerësimin e efektivitetit të trajtimit të kërkuar; megjithatë, duke u ndihmuar nga një avokat gjatë gjithë procedimit të brendshëm, kërkuesi mund të ishte treguar i hapur ndaj përpjekjeve të autoriteteve në përgjigje të konstatimeve të Dhomës. Kërkuesi e kishte të drejtën të refuzonte pranimin e trajtimit të propozuar për të; megjithatë, në këtë rast ai kishte riskuar uljen e mundësive për lirim.

Së treti, periudha e shkurtër që kishte kaluar qysh nga ky ndryshim e bënte të mundur vlerësimin e ndikimit të këtyre masave të reja.

Kështu, pavarësisht mangësive të caktuara organizative, pragu i ashpërsisë i kërkuar për aktivizimin e Nenit 3 nuk ishte arritur për këtë periudhë.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (katërbëdhjetë vota me tre).

Neni 5, par 1

(a) *Qartësimi i parimeve në lidhje me detyrimin për tu ofruar trajtim personave në ndalim të detyruar* – Edhe siç interpretohet tashmë, Neni 5 nuk përmban ndonjë pengesë për ndalimin mbi bazën e përqendrimit (ndryshe nga sa u propozua nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar). Megjithatë, heqja e lirisë sipas Nenit 5, par 1, (e) të Konventës duhej të përmbushte një funksion të dyfishtë: nga njëra anë, funksionin social të mbrojtjes; dhe, nga ana tjetër, një funksion terapik, në interes të personit me çrregullime mendore.

Funksioni i parë nuk duhet, *a priori*, të justifikojë mungesën e masave që synojnë përmbushjen e së dytës. Pavarësisht nga institucioni, çdo ndalim i personave të sëmurë mendërisht duhet të ketë një qëllim terapik, që të synojë, sa të jetë e mundur, kurimin ose zbutjen e gjendjes së shëndetit

mendor, duke përfshirë sipas rastit, realizimin e uljes ose kontrollit të rrezikshmërisë, me qëllim përgatitjen e tyre për lirim të mundshëm.

Dispozita e trajtimit të përshtatshëm dhe të individualizuar ishte një pjesë thelbësore e nocionit ‘institucion i përshtatshëm’: ishte e mundur që një institucion i cili ishte *a priori* i papërshtatshëm, si një strukturë burgu, megjithatë mund të quhet i pranueshëm nëse ofron kujdes të përshtatshëm, dhe anasjelltas, që një institucion psikiatrik i cili, për nga përkufizimi, mund të jetë i përshtatshëm mund të dalë i papërshtatshëm për të dhënë trajtimin e nevojshëm. Thjesht ‘aksesi’ të profesionistët e shëndetit, konsultimet dhe ofrimi i mjekimit nuk mund të mjaftojë këtu.

Megjithatë, roli i Gjykatës nuk ishte të analizonte përmbajtjen e trajtimit që ofrohej dhe administrohej; ajo që ishte e rëndësishme ishte që Gjykata të mund të verifikonte nëse një ‘program i individualizuar’ ishte bërë funksional, duke marrë parasysh hollësitë specifike të shëndetit mendor të ndaluarit me qëllim përgatitjen e tij ose saj për riintegrimin e mundshëm në të ardhmen në shoqëri. Në këtë fushë, Gjykata u jep autoriteteve një marzh të caktuar në lidhje me formën dhe përmbajtjen e kujdesit terapistik ose të programit mjekësor në fjalë.

Së fundi, në rastin kur një problem pengon trajtimin e kërkuesit, pasojat e mundshme negative për mundësinë e ndryshimit në situatën personale të kërkuesit nuk do të sillnin domosdoshmërisht në konstatimin e shkeljes së nenit 5, par 1, me kusht që autoritetet të kenë ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për ta tejkaluar këtë.

Intensiteti i shqyrtimit nga Gjykata do të ndryshonte në varësi të faktit nëse një ankim është paraqitur sipas Nenit 3 - që presupozonte një prag të caktuar rëndësie, ku vlerësimi ishte relativ dhe varej nga të gjitha rrethanat e çështjes - apo neni 5, par 1, - ku çështja e përshtatshmërisë së institucionit do të predominonte (e nevojshme për të ruajtur lidhjen ndërmjet ndalimit të detyruar dhe qëllimit të deklaruar). Një konstatim që nuk ka patur shkelje të Nenit 3 nuk do të çonte automatikisht në një konstatim që nuk ka patur shkelje të Nenit 5, par 1; megjithëse një konstatim i shkeljes së Nenit 3 për shkak të mungesës së trajtimit të përshtatshëm mund të rezultonte gjithashtu në një konstatim që ka patur një shkelje të Nenit 5, par 1, për të njëjtat shkaqe.

Dihet që Neni 5, par 1 (e), nuk i garantonte një individ në ndalim të detyruar të drejtën për të marrë trajtim në gjuhën e tij ose të saj. Megjithatë, nevoja për trajtim të personalizuar dhe të përshtatshëm të personave në ndalim të detyruar është theksuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2006), dhe nga Rekomandimi Rec (2004) 10 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave me çrregullime mendore - që rekomandonin, posaçërisht, përpilimin e një plani të përshtatshëm dhe të individualizuar trajtimi, pas konsultimeve (për sa është e mundur) me personin përkatës. Ishte e natyrshme të merrej parasysh faktori gjuhë, kështu që individ në fjalë të mund të merrte informacionin e nevojshëm në lidhje me trajtimin (mosbërja e kësaj mund të rrisë vulnerabilitetin e tij ose të saj).

*(b) Zbatimi në çështjen konkrete*

– *Periodha nga viti 2004 deri në vitin 2017* – Megjithëse gjermanishtja kishte statusin e një gjuhe zyrtare në Belgjikë, ajo nuk flitej shpesh në rajonin ku gjendej institucioni në fjalë. Për më tepër, legjislacioni i zbatueshëm nuk kërkonte që ky lloj institucioni të punësonte personel që ishte dy-gjuhësh në frëngjisht dhe gjermanisht.

Megjithatë, e drejta e kërkuarit për të folur, për tu kuptuar dhe marrë trajtimin në këtë gjuhë ishte e njohur shprehimisht nga bordi i mbrojtjes sociale në vitin 2009, megjithëse dukej sikur më vonë kishte pranuar idenë që ky aspekt nuk ishte vendimtar për përparimin dhe refuzoi të nixirte urdhra apo kritikonte autoritetet. Gjykata nuk mund të spekulonte se cili ishte rezultati që mund të merrej nga trajtimi në gjermanisht; ajo duhej të kufizohej duke vënë në dukje mungesën e një trajtimi të tillë. Për më tepër, mundësia që individ përkatës nuk mund të kurohej nuk e ulte detyrimin për të dhënë trajtim

Duke marrë parasysh kërkesat e kërkuarit për trajtim dhe lirim u takonte autoriteteve të gjenin një mënyrë për të tejkaluar këtë ngërç që rridhte nga problemi i komunikimit ndërmjet tij dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor. Nuk i takonte Gjykatës për të vendosur në një mënyrë të përgjithshme në lidhje me zgjidhjet që mund të ishin konsideruar të mjaftueshme: kjo zgjedhje i takonte marzhit të vlerësimit të autoriteteve.

Në çështjen konkrete, masat sporadike të autoriteteve nuk kishin qenë pjesë integrale e ndonjë kujdesi terapik apo mënyrë trajtimi. Mundësia e trajtimit të kërkuarit në Gjermani ishte eksploruar nga autoritetet, por nuk kishte asnjë informacion në lidhje me rezultatet e këtyre përpjekjeve. Në Belgjikë vetë, tejkalimi i problemit në lidhje me përdorimin e gjuhës gjermane nuk dukej jo-realiste, duke ditur që kjo ishte një nga gjuhët zyrtare të vendit.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

– *Periudha nga gushti 2017* – Duke ditur që kërkuari konsiderohej të ishte në gjendje të merrte vendimet e veta dhe të jepte pëlqimin, ligji i brendshëm e ndalonte imponimin e masës terapike mbi të kundër vullnetit të tij. Sipas përkufizimit, aftësia e tij u dobësua nga çrregullimet e tij psikologjike, që rritën vulnerabilitetin e tij. Autoritetet ishin të detyruara të përfshinin kërkuarin, në masën që ishte e mundur, në një trajtim mjekësor të individualizuar në gjendje për të sjellë një përmirësim në shëndetin e tij.

Në këtë rast, autoritetet kishin miratuar një qëndrim multi-disiplinor dhe - në pamje - koherent, ndërmjet disa aktorëve, në përpjekje për të garantuar që ‘rruga e kujdesit’ e kërkuarit të ishte e përshtatur me nevojat dhe patologjinë e tij specifike të komunikimit. Seria e aktiviteteve në gjermanisht (duke ofruar një psikiatër, psikolog dhe punonjës social gjermanisht-folës) ishte e tillë që të lehtësonte komunikimin dhe ndërtimin e një marrëdhënieje besimi.

Për më tepër, avokati personal i kërkuarit ose përfaqësuesi i tij ligjor, sipas rastit, kishin një rol aktiv për ta ndihmuar atë në ushtrimin e të drejtave të tij për të dhënë pëlqimin dhe përfitua nga plani i trajtimit. Megjithatë asistencën e përfaqësuesve të tij, kërkuari refuzoi të bashkëpunonte me personelin mjekësor në përpilimin e një plani trajtimi.

Në këtë situatë - në mungesë të informacionit të tillë si, për shembull, një refuzim nga psikiatri gjermanisht-folës për të takuar kërkuarin dhe për të përpiluar me të një projekt të përshtatshëm terapik -, Gjykata konsideroi që detyrimi i Shtetit në lidhje me mjetet ishte përmbushur.

Shkurtimisht, duke patur parasysh veçanërisht përpjekjet e konsiderueshme të bëra nga autoritetet, që faktikisht ishin koherente dhe të përshtatura me trajtimin mjekësor që tashmë ofrohej, periudha e shkurtër nën shqyrtim dhe faktin që kërkuari nuk ishte gjithmonë i hapur, pavarësisht asistencës

së përfaqësuesve të tij, ndalimi i detyruar i kërkuesit përputhej me qëllimin e kërkuar terapisë.

Megjithatë, Gjykata specifikoi që, duke patur parasysh vulnerabilitetin e kërkuesit dhe aftësinë e tij të dobët për të marrë vendime, autoritetet mbeten nën detyrimin e garantimit që të merreshin të gjitha iniciativat e nevojshme, në një afat-shkurtër dh afat-gjatë, për të garantuar trajtimin psikiatrik dhe psikologjik dhe asistencën sociale, për ti dhënë atij mundësinë e lirisë.

**Përfundimi:** Nuk ka shkelje (dhjetë vota me shtatë).

Neni 41: 32 500 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih gjithashtu raportin faktik në Ndalimi dhe shëndeti mendor)

## Neni 6

### Neni 6-2

#### Prezumimi i pafajësisë

Konstatimi i fajit për kundërvajtjen e përsëritur ndërsa ankimi për veprën fillestare është në shqyrtim e sipër: shkelje

**Kangers kundër Latonisë** - A.nr. 35726/10 Vendimi 14.3.2019 (Seksioni V)

**Faktet** – Në shkurt të vitit 2009, kërkuesit iu ndalua drejtimi i automjetit për shkak të kryerjes së kundërvajtjes së drejtimit të automjetit në gjendje të dehur. Në korrik të vitit 2009, policia përpiloi një raport për kundërvajtje administrative duke theksuar që kërkuesi kishte drejtuar një automjet duke mos e patur këtë të drejtë. Kërkuesi bëri ankim.

Pra se të merrej vendimi për ankimin, në shtator 2009, policia bëri një raport tjetër për kundërvajtje administrative duke theksuar që kërkuesi kishte drejtuar një automjet duke mos e patur këtë të drejtë dhe që kundërvajtja ishte kryer e përsëritur brenda një viti. Ankimi i kërkuesit nuk u rrëzua.

**Ligji** – Nuk ka shkelje (dhjetë vota me shtatë): Në lidhje me rastin e tretë të procedimit për kundërvajtje administrative, gjykatat e brendshme kishin konstatuar që kërkuesi kishte kryer kundërvajtjen e drejtimit duke mos e patur këtë të drejtë në mënyrë të përsëritur brenda një viti. Duke e bërë këtë, gjykatat iu referuan shprehimisht raportit për kundërvajtje administrative të muajit korrik 2009 në lidhje me të cilin për ankimin nuk ishte vendosur akoma. Përfundimi që vepra penale fillestare përbënte bazën për përsëritshmërinë nënkuptonte në çdo rast që kërkuesi e kishte kryer kundërvajtjen fillestare.

Prezumimet e faktit ose të ligjit që vlejné në çdo rend juridik dhe Konventa nuk e pengojné këtë në parim. Megjithatë, Shteteve u kërkohet ta mbanin këtë brenda kufijve të arsyeshëm që merrnin parasysh rëndësinë e asaj për të cilën bëhet fjalë dhe të respektonin të drejtën e mbrojtjes. Në rastet kur Gjykata kishte analizuar prezumimet e faktit ose të ligjit në kontekstin e procedimeve penale, ajo i kushtonte rëndësi të veçantë garancive procedurale dhe mjeteve të mbrojtjes të disponueshme për të akuzuarin për kundërshtimin e këtyre prezumimeve. Nëse garancitë procedurale të disponueshme për kundërshtimin e prezumimeve konsiderohej të mungonin, prezumimi i pafajësisë dukej se ishte shkelur.

Kërkuesi ishte shpallur fajtor për një kundërvajtje të përsëritur dhe jo për drejtim automjeti pa e patur këtë të drejtë dhe, si e tillë, atij jo vetëm i ishte vënë një gjobë më e lartë, por edhe ndalimi prej pesë ditësh që ai duhej të vuante para se të përfundohej procedimi në lidhje me kundërvajtjen fillestare. Presumimi në rastin e kërkuesit kishte të bënte me faktin që ai kishte kryer një kundërvajtje që ishte objekti i një procedimi tjetër. Gjykatat e brendshme e konsideruan veten e tyre për të qenë ligjërisht të detyruar nga raporti për kundërvajtjen administrative në lidhje me kundërvajtjen fillestare, pavarësisht faktit që ajo po ankimohej. Për pasojë, kërkuesi ishte lënë pa mjete mbrojtjeje në lidhje me këtë prezumim.

**Përfundimi:** shkelje (gjashtë vota me një)

Neni 41: konstatimi i një shkeljeje përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet.

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

##### Detyrime pozitive

Dështimi për të hetuar efektivisht për ndërhyrjet në jetën e gazetarit të mirënjohur: *shkelje*

## Neni 10

##### Detyrime pozitive

Dështimi për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së gazetarit: *shkelje*

***Khadija Ismayilova kundër Azerbajxhanit*** - A.nr. 65286/13 dhe 57270/14  
Vendimi 10.1.2019 (Seksioni V)

***Faktet*** – Kërkuesja, një gazetare e mirënjohur investigative dhe tepër kritike me Qeverinë, kishte publikuar artikuj që vinin në dukje korrupsionin që përfshinin Presidentin dhe familjen e tij. Në vitin 2012, ajo mori një letër kërcënuese që i kërkonin të ndërpriste aktivitetet e saj. Në apartamentin e saj ishin montuar kamera të fshehta nga persona të panjohur pa dijeninë dhe pëlqimin e saj dhe prej saj ishin marrë foto intime fshehtazi dhe ishin shpërndarë në internet.

Gjatë hetimit penal që pasoi, kërkuesi bëri një ankesë që autoritetet e ndjekjes penale po refuzonin të ndërmerrnin hapat hetimore të dukshëm dhe të thjeshtë. Në përgjigje, autoritetet hetimore publikuan një raport mbi statusin e hetimit. Ky raporti për statusin pretendonte që kërkuesja dhe avokati i saj po përhapnin informacion të rremë në media dhe vazhdonte më tej me deklarin e të dhënave personale sensitive, si emrat dhe adresat e miqve të saj, familjes dhe kolegëve.



Kërkuesja u ankua që të drejtat e saj sipas Neneve 8 dhe 10 ishin shkelur, për shkak të mos-mbrojtjes nga ana e autoriteteve të saj nga ndërhyrjet e pajustificuara në jetën e saj private të lidhura me punën e saj si gazetar.

### **Ligji – Neni 8**

(a) *Letra kërcënuese, filmimi i fshehtë dhe shpërndarja e videove intime* – Veprimet për të cilat është bërë ankimi janë të rënda dhe ofendim për dinjitetin njerëzor. Ekzistonte një lidhje konkrete ndërmjet aktivitetit profesional të kërkueses dhe këtyre ndërhyrjeve, qëllimi i të cilave ishte që asaj ti mbyllnin gojën. Në një situatë kur kërkuesja ishte e mirë-njohur në shoqëri veçanërisht për aktivitetin e saj gazetaresk, ishte e vështirë të dallohej ndonjë motiv për kërcënimin me poshtërim publik të marra prej saj, përveç se një motiv të lidhur me këtë aktivitet. Mungesa e një motivi të tillë mund të demonstrohej vetëm nëse kjo mund të përjashtohej në mënyrë përfundimtare dhe bindëse si rezultat i një hetimi të efektshëm. Për pasojë, ky aspekt i çështjes e bënte atë të një rëndësie të veçantë për të hetuar nëse kërcënimi ishte i lidhur me aktivitetin profesional të kërkueses dhe nga kush ishte bërë. Megjithëse pretendimet e kërkueses që agjentët shtetërorë mund të jenë pas veprës penale të kryer në dëm të saj nuk mbështeteshin nga prova që të përmbushin standardin e provës që kërkohet për të gjetur një shkelje të detyrimit negativ sipas nenit 8, argumentet e saj në këtë aspekt ishin të forta dhe nuk mund të injoroheshin si haptazi të papërdorshme. Kështu, këto argumente e kishin të nevojshme të hetoheshin për të gjetur prova mbështetëse.

Qysh në fillim, autoritetet hetimore kishin disa tregues të ndryshëm dhe të qartë, megjithatë nuk kishin ndërmarrë hapa të mjaftueshëm në këtë aspekt. Nuk ishte vënë në dukje në mënyrë të besueshme që autoritetet hetimore të kishin marrë deklarin e një dëshmitari të rëndësishëm në një mënyrë të përshtatshme ose që ata të kenë ndjekur ndonjë pistë që rridhte nga kjo deklaratë. U krijua përshtypja që në takimin e tyre të parë, hetuesi nuk regjistroi si duhet dhe pothuajse aktivisht shmangu regjistrimin e deklarimeve të dëshmitarit, të cilat ishin tepër të rëndësishme për çështjen. Nuk kishte informacion që të tregonte që ishin ndërmarrë hapa për të identifikuar personin i cili kishte dërguar letrën kërcënuese, pronarët dhe/ose operatorët e faqeve në internet në të cilat ishin ngarkuar fotot, dhe as identiteti i personave që i kishin ngarkuar.

Duke patur parasysh të metat e konsiderueshme në mënyrën se si autoritetet e kishin hetuar çështjen, si dhe gjatësinë e procedimit, autoritetet nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të garantuar mbrojtjen e përshtatshme të jetës private të kërkuarit duke zhvilluar një hetim penal të efektshëm në ndërhyrjet e rënda në jetën e saj private.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

(b) *Publikimi nga autoritetet i raportit për statusin e hetimit* – Raporti i statusit i publikuar në shtyp nga autoritetet e ndjekjes penale deklaronte hollësi sensitive private të përfuara në kuadrin e hetimit penal. Qeveria nuk ishte në gjendje të demonstronte as një qëllim legjitim dhe as domosdoshmërinë për ndërhyrjen në fjalë. Do të ishte e mundur të informohej publiku në lidhje me natyrën e hapave hetimorë të ndërmarrë nga autoritetet, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar jetën private të kërkuarës, që ishte e një rëndësie vendimtare në të gjithë kontekstin e çështjes, duke ditur që hetimi penal vetë kishte filluar në lidhje me ndërhyrjen e pajustificuar dhe flagrante në jetën e saj private. Situata u kërkonte autoriteteve të ushtronin kujdesin e tyre me qëllim që të mos përkeqësuar më tej shkeljen ekzistuese të jetës private të kërkuarës.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 10: Veprimet e një natyre kriminale të kryera në dëm të kërkuarës dukej se ishin të lidhura me aktivitetin e saj gazetaresk; nuk ishte identifikuar apo dalluar asnjë motiv tjetër i mundshëm për ngacmimin me të cilin ajo duhej të përballlej. Kërkuarja kishte shprehur në mënyrë të përsëritur shqetësimet dhe frikën e saj që ajo ishte viktimë e një fushate të organizuar dhe orkestruar si hakmarrje për punën e saj si gazetare, në vëmendje të autoriteteve.

Në këto rrethana, duke patur parasysh raportet mbi situatën e përgjithshme në lidhje me lirinë e shprehjes në vend dhe rrethanat e posaçme të çështjes së kërkuarës, kërcënimi i poshtërimit publik dhe veprimet që rezultojnë në ndërhyrje flagrante dhe të pajustificuar në jetën private të kërkuarës kishin të bënin me aktivitetin gazetaresk ose duhej të trajtoheshin nga autoritetet gjatë hetimit sikur ta kishin këtë lidhje. Në këtë situatë, Neni 10 i kërkonte Shtetit të paditur të ndërmernte masa pozitive për të mbrojtur lirinë gazetareske të shprehjes së kërkuarës, përveç detyrimeve të tij

pozitive sipas Nenit 8 për ta mbrojtur atë nga ndërhyrja në jetën e saj private.

Megjithëse autoritetet kishin filluar një hetim penal, ka patur mangësi të konsiderueshme dhe vonesa në mënyrën se si ata e kishin hetuar çështjen. Për më tepër, artikujt e botuar në gazeta, që kërkuesi pretendonte se ishin në favor të qeverisë, si dhe deklarimi i pajustificuar publik nga autoritetet i informacionit shtesë në lidhje me jetën private të kërkueses, e komplikonin më tej situatën, në kundërshtim me frymën e një mjedisi mbrojtës për gazetarinë.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Neni 41: 15,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Huseynova kundër azerbajxhanit*, [10653/10](#), 13 prill 2017, *Shënim Informativ 206*; *Uzeyir Jafarov kundër azerbajxhanit*, [54204/08](#), 29 janar 2015; dhe Rekomandimin [CM/Rec\(2016\)4](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Shtetet anëtare mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias)

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

Mosreagimi ndaj ndotjes së ajrit nga fabrikat e çelikut, në dëm të shëndetit të popullatës përreth: *shkelje*

## Neni 46

### Neni 46-2 Ekzekutimi i vendimit

***Cordella dhe të Tjerë kundër Italisë*** - A.nr. 54414/13 dhe 54264/15 Vendimi 24.1.2019 [Seksioni I]

## Masat e përgjithshme

Shtetit të paditur i kërkohet të marrë masa të përgjithshme përballë ndotjes së vazhdueshme të ajrit nga emisionet e fabrikave, që ndikojnë në shëndetin e personave që banojnë në bashkitë përreth.

**Faktet** – Çështja kishte të bënte me ndotjen në vazhdim të ajrit nga fabrikat e çelikut, që operonin qysh në vitin 1965 në Taranto (një qytet me rreth 200 000 banorë) dhe në pronësi të një shoqërie të mëparshme publike e cila u privatizua në vitin 1995. Në vitin 1990, një rezolutë e Këshillit të Ministrave identifikoi qytetin e Tarantos dhe katër bashki të tjera përreth si në ‘risk të lartë mjedisor’ për shkak të emisioneve nga fabrikat e çelikut. Në vitin 1998, Presidenti i Republikës aprovoi një plan dekontaminimi. Në vitin 2000, një dekret ministerial përfshinte bashkitë e Tarantos dhe Stattes në ‘vende me interes kombëtar për dekontaminim’ (SIN). Autoritetet lidhën marrëveshje me shoqërinë. Në vitin 2011, kushtet lëndore dhe në lidhje me informacionin u vendosën në kontekstin e një licence operative administrative. Disa dekrete legjislative që synonin ruajtjen e aktivitetit të prodhimit të çelikut në Taranto, të miratuara nga viti 2012 e në vijim, i zgjatën afatet e caktuara. Në vitin 2015, si rezultat i paaftësisë paguese të saj, shoqëria u vendos në administrim të detyruar dhe administratori u përjashtua nga përgjegjësia administrative dhe penale në prezantimin e masave të planifikuara mjedisore. Ndërkohë, institucionet e Bashkimit Europian (Gjykata e Drejtësisë dhe Komisioni) nxorën përfundimin që Italia kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit të saj për të garantuar përputhshmëri me direktivat e zbatueshme. U filluan disa procedime civile dhe penale. megjithatë, emisionet toksike vazhdonin.

Kërkuesit janë disa dhjetëra persona fizikë që banojnë ose banonin pak a shumë në afërsi të fabrikave të çelikut. Ata u ankuan për mungesë masash nga Shteti për të mënjeluar efektet e emisioneve toksike të fabrikës për shëndetin e tyre.

## Ligji

Neni 8: Ndërsa nuk ishte detyra e Gjykatës për të përcaktuar saktësisht cilat masa duhet të ishin ndërmarrë në këtë çështje për të ulur ndotjen në një mënyrë më eficiente, natyrisht ishte brenda juridiksionit të Gjykatës për të vlerësuar nëse autoritetet e brendshme e kishin trajtuar problemin me

kujdesin e duhur dhe kishin trajtuar të gjithë interesat konkurrues. Barra e provës këtu i takonte Shtetit për të justifikuar, duke përdorur të dhëna rigorozë dhe të detajuara, një situatë në të cilën individë të caktuar mbani një barrë më të rëndë në emër të pjesës tjetër të komunitetit.

Megjithatë, qysh nga viti 1970, studimet shkencore (pjesa më e madhe e të cilëve ishin nga subjektet shtetërore dhe rajonale) kishin treguar efektet ndotëse të emisioneve nga fabrikat e çelikut Ilva në Taranto mbi mjedisin dhe shëndetin publik. Këto studime kishin konfirmuar ekzistencën e një lidhjeje shkakësore ndërmjet ekspozimit mjedisor të disa substancave që merreshin me frymëmarrje të emetuara nga fabrika dhe zhvillimit të tumoreve të caktuar ose patologjive kardio-qarkullatore (studimi i vitit 2012) dhe rritjes së vdekshmërisë nga shkaqet natyrore, tumoreve dhe sëmundjeve të veshkave dhe kardio-vaskulare (studimi i vitit 2016) nga personat që banonin në zonat e prekura. Një sondazh i publikuar në vitin 2017 kishte treguar vazhdimësinë e një situatë kritike shëndetësore në bashkitë e identifikuar si me risk mjedisor të lartë (Taranto kishte vdekshmëri dhe norma shtrimi në spital në lidhje me patologjitë përkatëse që ishin më të larta se mesatarja rajonale).

Përpjekjet e autoriteteve të brendshme për të arritur dekontaminimin e rajonit në fjalë nuk kishte dhënë deri tani rezultatet e dëshiruara. Masat e rekomanduara nga viti 2012 e në vijim në kontekstin e një dekreti administrativ mjedisor ('AIA') në fund të fundit nuk ishin marrë (faktikisht, ky mosveprim ishte në fillesën e një procedure shkeljeje para institucioneve të Bashkimit Europian). Për më tepër, zbatimi i planit mjedisor i aprovuar në vitin 2014 ishte shtyrë për në gusht të vitit 2012. Kështu, arritja e objektivave të identifikuar të dekontaminimit ishte tepër e ngadaltë.

Ndërkohë, Qeveria kishte ndërhyrë vazhdimisht (nëpërmjet dekreteve të posaçme legjislativë) për të garantuar që fabrikat e çelikut të vazhdonin prodhimin, pavarësisht konstatimeve nga autoritetet përkatëse gjyqësore, bazuar në raportet e ekspertëve kimistë dhe epidemiologjikë, që ekzistonin risqe serioze për shëndetin dhe mjedisin. Përveç kësaj, personave përgjegjës për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat mjedisore u ishte dhënë imunitet administrativ dhe penal (administratori i detyruar dhe blerësi i ardhshëm i shoqërisë). Kjo situatë u përkeqësua më tej nga pasiguria që rridhte, nga njëra anë, nga gjendja e dështuar financiare e shoqërisë dhe,

nga ana tjetër, nga opsioni i dhënë blerësit të ardhshëm për të zvarritur operacionet e pastrimit brenda fabrikës.

Për pasojë, u duk se për sa kohë kjo kishte të bënte me përgjegjësinë e autoriteteve, menaxhimi i çështjeve mjedisore të ngritura nga fabrikat e Tarantos mbeti i bllokuar. Kështu, vazhdoi një situatë e ndotjes mjedisore që rrezikonte shëndetin e kërkuesve dhe, në përgjithësi, atë të të gjithë popullatës që banonte në zonat e riskuara, një popullatë që, në situatën ekzistuese, mbeti pa informacion në lidhje me progresin e operacionit të pastrimit në territorin përkatës, posaçërisht në lidhje me afatet kohore për fillimin e punës përkatës. Shkurtimisht, autoritetet e brendshme kishin dështuar në marrjen e masave të nevojshme për të ofruar mbrojtje efektive për të drejtat e kërkuesve në lidhje me jetën e tyre private; balanca e nevojshme dhe e drejtë nuk ishte gjetur.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Neni 46: Duke patur parasysh, *inter alia*, kompleksitetin teknik të masave për dekontaminimin e zonës në fjalë, që përfshihej nën kompetencën e autoriteteve të brendshme, nuk ishte e nevojshme të zbatohet procedura e ‘vendimit pilot’. Nuk i takon Gjykatës ti japë Qeverisë rekomandime të hollësishme dhe të përshkruara, si ato që kërkohen nga kërkuesit: i takon Komitetit të Ministrave ti tregojë Qeverisë së paditur masat që duhet të merren për ekzekutimin e këtij vendimi. Megjithatë, mbetet fakt që puna dekontaminuese për pastrimin e fabrikës dhe rajonit të ndikuar nga ndotja mjedisore ishte thelbësore dhe urgjente. Plani mjedisor i aprovuar nga autoritetet e brendshme, duke caktuar masat dhe veprimet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen mjedisore dhe shëndetësore të popullatës, duhej të zbatohet sa më shpejt të ishte e mundur.

Gjykata gjithashtu konstatoi njëzëri që ka patur një shkelje të Nenit 13 të lexuar në lidhje me Nenin 8 të Konventës.

Neni 41: konstatimi i një shkeljeje përbënte një kompensim të mjaftueshëm për dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Fadeyeva v. Russia*, [55723/00](#), 9 June 2005, Shënim Informativ 76; *Di Sarno dhe të tjerë v. Italy*, [30765/08](#), 10 janar 2012, Shënim Informativ 148; *Jugheli dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, [38342/05](#), 13 korrik 2017, Shënim Informativ 209; dhe Raporti Faktik mbi Mjedisi)

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

Kompetenca e punonjësve të kontrollit të kufirit për të ndaluar dhe pyetur pa patur dyshim ose akses tek avokati: *shkelje*

***Beghal kundër Mbretërisë së Bashkuar*** - A.nr. 4755/16 Vendimi 28.2.2019 (Seksioni I)

**Faktet** – Kërkesja, një shtetase franceze, ishte me banim të zakonshëm në Mbretërinë e Bashkuar. Bashkëshorti i saj, gjithashtu shtetas francez, ishte i ndaluar në Francë në lidhje me vepra penale terroriste. Pas një vizite tek bashkëshorti i saj, kërkesja u ndalua në aeroportin East Midlands dhe u pyet sipas Grafikut 7 të Ligjit për Terrorizmin të vitit 2000. Ajo dhe bagazhi i saj u kontrolluan. Kërkesja refuzoi tu përgjigjej pjesës më të madhe të pyetjeve që iu bënë asaj. Kërkesja në vijim u akuzua, ndërmjet të tjerash, për mospërbushje me dashje të një detyrimi sipas Grafikut 7.

Grafiku 7 i jepte të drejtë policisë, punonjësve të emigracionit dhe të doganave të ndalonin, merrnin në pyetje dhe të kontrollonin pasagjerët në porte, aeroporte dhe терминаlet ndërkombëtarë të trenave. Marrja në pyetje duhej të ishte me qëllim konstatimin nëse personi duket se është përfshirë apo të ketë qenë përfshirë në kryerjen, përgatitjen ose nxitjen e akteve të terrorizmit. Nuk kërkohej autorizim paraprak dhe kompetenca për të ndaluar dhe pyetur mund të ushtrohej edhe pa dyshimin e përfshirjes në terrorizëm.

**Ligji** – Neni 8 Çështja kryesore ishte nëse garancitë e parashikuara në ligjin e brendshëm mbulonin mjaftueshëm kompetencat sipas Grafikut 7 për ti ofruar kërkuarës mbrojtjen e përshtatshme ndaj ndërhyrjes arbitrare në të drejtën e saj të respektimit të jetës së saj private.

(a) *Objekti territorial dhe kohor i kompetencave* – Kompetencat sipas Grafikut 7 ishin të gjera në objektin e tyre, duke patur zbatim të përhershëm në të gjitha portet dhe kontrollet kufitare. Kjo, në vetvete, nuk binte në

kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Kontrollët në porte dhe kufi do të përbënin një pikë themelore për zbulimin dhe parandalimin e lëvizjeve të terroristëve dhe/ose shkatërrimin e sulmeve terroriste. Në fakt, të gjithë Shtetet kishin sisteme të kontrollit të emigracionit dhe doganave në portet dhe kufijtë e tyre dhe, ndërsa këta kontrolle ishin të ndryshëm në natyrë nga kompetencat e Grafikut 7, megjithatë në këtë situatë të gjithë personat që kalonin kufijtë ndërkombëtare mund të prisnin ti nënshtroheshin një niveli të caktuar kontrolli.

*(b) Diskrecioni dhënë autoriteteve për të vendosur nëse dhe kur të ushtrohen kompetencat* – Punonjësit kontrollues kishin një diskrecion të gjerë meqenëse ‘terrorizmi’ ishte një përkufizim i gjerë dhe kompetencat e Grafikut 7 mund të ushtroheshin pavarësisht nëse ai ose ajo kishte shkaqe objektive apo subjektiv për dyshim. Një kërkesë e dyshimit të arsyeshëm ishte një konsideratë e rëndësishme në vlerësimin e ligjshmërisë së një kompetence për të ndaluar dhe pyetur ose kontrolluar një person; megjithatë, asgjë nuk tregonte që ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm në vetvete ishte e nevojshme për të shmangur arbitraritetin. Për më tepër, ky ishte një vlerësim që duhej të bëhej duke patur parasysh operimin e skemës si një e tërë dhe mungesa e një kërkesë të dyshimit të arsyeshëm në vetvete nuk e bënte ushtrimin e kompetencës në rastin e kërkuësës të paligjshme.

Kishte prova të qarta që kompetencat e Grafikut 7 kishin qenë një vlerë e vërtetë në mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Nëse do të kërkohej ‘dyshimi i arsyeshëm’, terroristët mund ta shmangnin kërcënimin parandalues të Grafikut 7 duke përdorur njerëz që nuk kishin tërhequr vëmendjen e policisë më parë dhe vetë fakti i ndalimit mund të vinte në dijeni një person në lidhje me ekzistencën e mbikëqyrjes.

Ishte e rëndësishme të bëhej dallimi ndërmjet dy kompetencave të dallueshme të Grafikut 7, që është kompetenca për të pyetur dhe kontrolluar një person dhe kompetenca për të ndaluar një person. Meqenëse kërkuësja nuk ishte ndaluar formalisht, shqyrtimi i gjykatës kufizohet në ligjshmërinë e kompetencës për të pyetur dhe kontrolluar. Ishte e rëndësishme që kompetenca sipas Grafikut 7 - dhe veçanërisht kompetenca për të pyetur dhe kontrolluar - ishte një kompetencë paraprake e hetimit e parashikuar shprehimisht për të ndihmuar punonjësit e vendosur në porte dhe kufij për të bërë hetime kundër terrorizmit për çdo person që hyn apo del nga vendi.



Ndërsa nuk kishte ndonjë kërkesë për 'dyshim të arsyeshëm', punonjësve kontrollues u ishin dhënë megjithatë udhëzime. Vendimi për të ushtruar kompetencat e Grafikut 7 duhej të bazoheshin në kërcënimin e përbërë nga grupe të ndryshme terroriste aktive dhe në një numër tjetër konsideratash si, për shembull, burimet e njohura ose të dyshuara të terrorizmit dhe aktiviteti i mundshëm i tashëm, në rritje ose i ardhshëm terrorist.

(c) *Çdo kufizim i ndërhyrjes së shkaktuar nga ushtrimi i kompetencave* – Në momentin që kërkuesi u mor në pyetje, Grafiku 7 parashikonte që një person i ndaluar nën këtë kompetencë duhej të lirohej jo më vonë se përfundimi i një periudhe prej nëntë orësh nga fillimi i marrjes në pyetje. Në fillim të marrjes në pyetje, punonjësi kontrollues duhej ti shpjegonte personit përkatëse verbalisht ose me shkrim që ai ose ajo po merrej në pyetje sipas Grafikut 7 dhe që nëpunësit kishin kompetencën ta ndalonin atë nëse ai apo ajo refuzonte të bashkëpunonte dhe insistonte për tu larguar. Për marrjen në pyetje duhej të mbahej një protokoll; në port, nëse marrja në pyetje zgjaste më pak se një orë, ose në qendër, nëse zgjaste më shumë. Megjithatë, megjithë faktin që personat që merreshin në pyetje ishin të detyruar tu përgjigjeshin pyetjeve që u bëheshin, as Ligji për Terrorizmin dhe as Kodi i Praktikës në fuqi në momentin përkatës nuk përmbanin dispozita për një person që merrej në pyetje (i cili nuk ishte i ndaluar) të kishte ndihmën e një avokati. Për pasojë, personat mund ti nënshtroheshin marrjes në pyetje deri në nëntë orë, pa asnjë kërkesë të dyshimit të arsyeshëm, pa qenë formalisht të ndaluar, dhe pa patur akses tek një avokat.

(d) *Mundësia e rishikimit gjyqësor të ushtrimit të kompetencave* – Ndërsa ishte e mundur të kërkohej rishikim gjyqësor i ushtrimit të kompetencave sipas Grafikut 7, nga çështjet e brendshme dilte që mungesa e çdo detyrimi nga ana e punonjësit kontrollues për të treguar 'dyshim të arsyeshëm' e bënte të vështirë për njerëzit që të realizonin rishikimin gjyqësor të ligjshmërisë së vendimit të ushtrimit të kompetencës.

(e) *Çdo mbikëqyrje e pavarur e përdorimit të kompetencave* – Përdorimi i kompetencave i nënshtrohej mbikëqyrjes së pavarur nga Rishikuesi i Pavarur i Legjislacionit për Terrorizmin. Rëndësia e rolit qëndron në pavarësinë e plotë nga qeveria, e kombinuar me aksesin e bazuar në një shkallë të lartë të lejes për informacionin e fshehtë dhe sensitiv të sigurisë kombëtare dhe personelin. Megjithatë, rishikimet e tij ishin gjithmonë *ad hoc* dhe në masën

që ai ishte në gjendje të rishikonte një përzgjedhje të protokolleve të marrjes në pyetje, ai nuk do të ishte në gjendje të vlerësonte ligjshmërinë e qëllimit të ndalimit. Për më tepër, ndërsa raportet e tij ishin verifikuar në nivelin më të lartë, një numër rekomandimesh të rëndësishme nuk ishin zbatuar. Veçanërisht, Rishikuesi i Pavarur kishte kërkuar vazhdimisht prezantimin e një kerkese për dyshim në ushtrimin e disa kompetencave të Grafikut 7, duke përfshirë kompetencën për të ndaluar dhe shkarkuar përmbajtjen e një telefoni apo laptop; dhe ka kritikuar faktin që përgjigjet e dhëna nën detyrim nuk ishin përcaktuar shprehimisht të pavlefshme në procedimet penale. Kështu, duke qenë me një vlerë të konsiderueshme, mbikëqyrja e Rishikuesit të Pavarur nuk ishte në gjendje të kompensonte garancitë e tjera të pamjaftueshme të zbatueshme për operimin e regjimit të Grafikut 7.

(f) *Përfundim* – Në momentin që kërkesja ishte ndaluar, kompetenca për të marrë në pyetje njerëzit sipas Grafikut 7 nuk ishte e kufizuar në masë të mjaftueshme dhe nuk i nënshtrohej garancive të përshtatshme ligjore ndaj abuzimeve. Ndërsa mungesa e çdo kerkese vetëm për ‘dyshim të arsyeshëm’ nuk ishte fatale për ligjshmërinë e regjimit, nëse konsiderohet së bashku me faktin që marrja në pyetje mund të vazhdojë deri në nëntë orë, kohë gjatë së cilës personi do të detyrohej tu përgjigjej pyetjeve pa patur të drejtën e pranisë së një avokati dhe mundësia e rishikimit gjyqësor të ushtrimit të kompetencës ishte e kufizuar, kompetencat e Grafikut 7 nuk ishin ‘në pajtim me ligjin’.

Gjykata nuk mori parasysh ndryshimet që erdhën nga Ligji i Sjelljes Anti-Sociale, Krimit dhe Policimit të vitit 2014 dhe Kodit të përditësuar të Praktikës; ajo nuk shqyrtoi as kompetencën për të ndaluar sipas Grafikut 7, që kishte potencialin e rezultimit në një ndërhyrje më të rëndë tek të drejtat e personit sipas Konventës.

***Përfundim:*** shkelje (njëzëri).

Neni 41: konstatimi i një shkeljeje përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me çdo dëm jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [4158/05](#), 12 janar 2010, Shënim Informativ 126)

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

Portali i lajmeve në internet nuk konsiderohet me faj në lidhje me komentet seksiste të vendosura në të nga palë të treta anonime: *nuk ka shkelje*

**Høiness kundër Norvegjisë** - A.nr. 43624/14 Vendimi 19.3.2019 (Seksioni II)

**Fakte** – Kërkuesja ishte një avokate e mirënjohur në Norvegji. Në vijim të artikujve në gazetë në lidhje me marrëdhëniet e saj me një të ve të moshuar nga i cili ajo do të trashëgonte, një portal online i lajmeve hapi një linjë diskutimi mbi këtë temë. Forumi mund të aksesohet nëpërmjet gazetës online. Pasuan, *inter alia*, komente vulgare dhe seksiste në lidhje me kërkuesen. Komentet u fshinë pas njoftimit, me iniciativën e vetë moderatorëve. Pas procedimit të pasuksesshëm të brendshëm, kërkuesja u ankua në Gjykatë që kishte një shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës private.

**Ligji** – Neni 8 Çështja ishte nëse Shteti kishte gjetur një balancë të drejtë ndërmjet së drejtës së kërkueses për respektimin e jetës së saj private sipas Nenit 8 dhe agjencisë online të lajmeve dhe të drejtës së shprehjes së forumit pritës të garantuar nga Neni 10. Nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej me thellësi natyra e komenteve të debatuar, pasi ato në asnjë mënyrë nuk përbënin gjuhë urrejtjeje ose nxitje për dhunë. Nuk kishte shkak për të kundërshtuar pretendimin e kërkueses që ajo do të përballlej me pengesa të konsiderueshme në përpjekje për të ndjekur pretendimet e saj kundër individëve anonimë ose individëve që kishin shkruar komentet.

Në lidhje me kontekstin në të cilin ishin bërë komentet, Gjykata vuri re që portali i lajmeve ishte i madh dhe i menaxhuar në mënyrë komerciale dhe që forumet e debatit ishin popullorë. Megjithatë, nuk dihte nga vendimet e gjykatave të brendshme që forumet e debatit ishin tepër të integruara në prezantimin e lajmeve dhe në këtë mënyrë mund të merreshin si vazhdim i artikujve editorialë. Në lidhje me masat e marra nga portali i lajmeve, dukej

se ekzistonte një sistem i mirë-vendosur moderatorësh që monitoronin përmbajtjen. Lexuesit mund të klikonin tek butonat e ‘paralajmërimit’ në faqen e internetit me qëllim që të reagonin ndaj komenteve. Dukej se një përgjigje ndaj paralajmërimeve mund të jepej edhe nëpërmjet mjeteve të tjera, siç është e-maili.

Dy nga komentet e kundërshtuara nuk ishin marrë nga moderatorët, por trembëdhjetë minuta pasi ata ishin njoftuar për shqetësimet, përfaqësuesi i kërkuësës mori një e-mail që shprehej se komentet ishin fshirë. Një koment tjetër ishte fshirë me iniciativën e vetë moderatorëve. Pas një shqyrtimi të përgjithshëm dhe vlerësimi të masave që ishin marrë me qëllim që të monitoroheshin komentet e forumit dhe përgjigjet specifike ndaj njoftimeve të kërkuësës, gjykatat e brendshme kishin konstatuar që shoqëria e portalit të lajmeve dhe editori i saj kishin vepruar përkatësisht.

Çështja e kërkuësës ishte konsideruar në themel nga dy shkallë të gjyqësorit në nivelin e brendshëm para se Gjykata e Lartë të refuzonte lejimin e ankimit. Gjykatat e brendshme kishin rishikuar aspektet përkatëse të çështjes dhe kishin vepruar brenda marzhit të vlerësimit të tyre në përpjekje për të vendosur një balancë të drejtë ndërmjet të drejtave të kërkuësës dhe atyre të portalit të lajmeve dhe pritësve të forumeve të debatit.

Gjykata vuri re shumën e konsiderueshme të shpenzimeve gjyqësore të vendosura për kërkuësen. Megjithatë, duke patur parasysh natyrën e pretendimit të ngritur para gjykatave të brendshme dhe objektin, ajo nuk ishte e mendimit që ajo duhej të vinte në pikëpyetje vlerësimin e gjykatave të brendshme në lidhje me caktimin e shpenzimeve.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

(Shih gjithashtu *Delfi AS kundër Estonisë* (DHM), [64569/09](#), 16 qershor 2015, *Shënim Informativ 186*; *Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër Hungarisë*, [22947/13](#), 2 shkurt 2016, *Shënim Informativ 193*; dhe *Pihl kundër Suedisë* (dec.), [74742/14](#), 7 shkurt 2017, *Shënim Informativ 205*)

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës familjare

Sistemim i përkohshëm në shtëpinë e fëmijës për shkak të refuzimit të prindërve për ti dërguar fëmijët në shkollë: *nuk ka shkelje*

***Wunderlich kundër Gjermanisë*** - A.nr. 18925/15 Vendimi 10.1.2019 (Seksioni V)

**Faktet** – Kërkuesit, një çift i martuar me katër fëmijë, ishin kundër sistemit të shkollave shtetërore, që kërkonin frekuentim të detyruar dhe dëshironin ti mësonin fëmijët vetë në shtëpi. Kërkuesit iu nënshtruan disa gjobave administrative dhe procedimeve penale; ata paguan gjobat e vendosura atyre, por nuk e ndryshuan qëndrimin e tyre.

Më 6 shtator 2012, Gjykata e Familjes ua tërhoqi kërkuesve të drejtën për të vendosur për vendbanimin e fëmijëve, si dhe të drejtën e tyre për të marrë vendime për çështjet shkollore dhe për të aplikuar tek autoritetet në emër të fëmijëve të tyre dhe ia transferoi këto të drejta zyrës së mirëqenies së të rinjve. Gjykata e Familjes gjithashtu urdhëroi kërkuesit t’ia dorëzonte fëmijët zyrës së mirëqenies së të rinjve, e cila do të zbatonte rregullat për frekuentimin e detyruar të shkollës. Në vijim të këtij vendimi, në shumica rate autoritetet u përpoqën të kryenin një vlerësim për të nxënëit e fëmijëve, por ata hasën kundërshtimin e kërkuesve.

Pas rrëzimit të ankimeve të kërkuesve ndaj vendimit të Gjykatës së Familjes, më 29 gusht 2013 fëmijët u transferuan nga shtëpia e kërkuesve dhe u sistemuan në shtëpinë e fëmijës për tre javë, gjatë të cilave ata iu nënshtruan testit për të vlerësuar njohuritë e tyre. Më 19 shtator 2013, fëmijët u kthyen kërkuesve, meqenëse këta të fundit kishin rënë dakord ti lejonin fëmijët e tyre të frekuentonin shkollën.

**Ligji**—Neni 8: Tërheqja e pjesshme e së drejtës prindërore, duke i transferuar të drejta të caktuara zyrës së mirëqenies së fëmijëve, duke larguar fëmijët e kërkuesve nga shtëpia e tyre dhe duke i vendosur ata në shtëpinë e fëmijës për tre javë përbënte ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për respektimin e

jetës familjare. Këto masa kishin qëllime legjitime për mbrojtjen e ‘shëndetit ose moralit’ dhe ‘të drejtat dhe liritë e të tjerëve’.

Gjykata kishte vlerësuar më parë sistemin gjerman të frekuentimit të detyruar të shkollës dhe konstatoi që ai bazohej në konsiderata që ishin në pajtim me praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës dhe që përfshiheshin brenda marzhit të vlerësimit të Shtetit të paditur. Ekzekutimi i frekuentimit të detyruar të shkollës për të parandaluar izolimin social të fëmijëve të kërkuesve dhe garantuar integritimin e tyre në shoqëri, ishte në këtë mënyrë arsyeja përkatëse për të justifikuar tërheqjen e pjesshme të së drejtës prindërore të kërkuesve. Autoritetet e brendshme në mënyrë të arsyeshme prezumuan që fëmijët e kërkuesve ishin të rrezikuar duke mos shkuan në shkollë dhe duke u mbajtur në sistemin familjar ‘simbiotik’.

Kërkuesit argumentuan që vlerësimi i të nxënit për fëmijët e tyre tregoi që ata kishin njohuri të mjaftueshme, aftësi sociale dhe një marrëdhënie miqësore me prindërit e tyre. Megjithatë, ky informacion nuk ishte i njohur për zyrën e mirëqenies së të rinjve ose gjykatat kur ata morën vendimet e tyre. Bazuar në informacionin e ofruar atyre në atë moment, autoritetet prezumuan normalisht që fëmijët ishin izoluar dhe u mungonte kontakti jashtë familjes dhe që ata ishin në risk të integritetit të tyre fizik. Gjykata në këtë kontekst vuri re që edhe gjykimet ose vendimet e gabuara nga profesionistët *si të tilla* nuk i bënë masat në lidhje me kujdesin për fëmijët të papajtueshme me kërkesat e Nenit 8. Autoritetet kishin për detyrë të mbronin fëmijët dhe nuk mund të nuk mund të fajësohen çdo herë që shqetësimet e vërteta dhe të arsyeshme në lidhje me sigurinë e fëmijëve *vis-à-vis* anëtarëve të familjeve të tyre dilnin me prapaveprim si të gabuara. Për më tepër, mosdisponimi i këtij informacioni ishte bazuar në rezistencën e vetë kërkuesve ndaj vlerësimit të të nxënit të fëmijëve që u zhvillua para se ata të vendoseshin nën kujdes.

Gjykata po ashtu vuri re që procesi i vendim-marrjes, i parë si i tërë, u ofroi kërkuesve të gjithë mbrojtjen e duhur për interesat e tyre dhe që kërkesat procedurale të shprehura në Nenin 8 të Konventës ishin respektuar. Veçanërisht Gjykata e Familjes dëgjoi kërkuesit, fëmijët e tyre dhe zyrën e mirëqenies së të rinjve dhe caktoi një kujdestar *ad litem* për fëmijët për të përfaqësuar interesat e tyre. Kërkuesit, të përfaqësuar nga avokati, ishin në gjendje të paraqisnin të gjitha argumentet e tyre kundër tërheqjes së përkohshme dhe të pjesshme të së drejtës prindërore.

Për më tepër, gjykatat e brendshme kanë dhënë arsye të hollësishme se pse masat me pak ndërhyrëse se vendosja e fëmijëve në kujdes nuk ishin të disponueshme. Ato ishin të mendimit që sjellja e mëparshme e kërkuësve dhe rezistenca e tyre konstante ndaj masave kishte treguar që thjesht dhënia e udhëzimeve do të ishte jo efektive, pasi gjocat e mëparshme administrative nuk kishin bërë të mundur të ndryshonin refuzimin e kërkuësve për të dërguar fëmijët e tyre në shkollë. Përfundimi nga gjykatat e brendshme në rrethanat e çështjes kishte qenë i arsyeshëm dhe proporcional.

Fëmijët u kthyen tek prindërit e tyre pasi u zhvillua vlerësimi i të nxëniet dhe kërkuësit kishin rënë dakord për ti dërguar ata në shkollë. Largimi faktik i fëmijëve nuk kishte zgjatur më shumë nga sa ishte e nevojshme, ishte në interesin e tyre më të mirë dhe nuk ishte zbatuar në një mënyrë që ishte tepër e ashpër ose e veçantë.

Në tërësi, ishin paraqitur arsyet 'përkatëse dhe të mjaftueshme' për tërheqjen e pjesshme të së drejtës prindërore të kërkuësve dhe largimin e përkohshëm të fëmijëve të tyre. Autoritetet e brendshme kishin gjetur një balancë të drejtë ndërmjet interesave më të lartë të fëmijëve dhe atyre të kërkuësve, të cilat nuk kishin dalë jashtë marzhit të vlerësimit të dhënë autoriteteve të brendshme.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

(Shih gjithashtu *Leuffen kundër Gjermanisë*, [19844/92](#), Vendim i Komisionit të datës 9 korrik 1992; *T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (DHM), [28945/95](#), 10 maj 2001; *K. dhe T. kundër Finlandës* (DHM), [25702/94](#), 12 korrik 2001, *Shënim Informativ 32*; *Konrad dhe të tjerë kundër Gjermanisë* (dec.), [35504/03](#), 11 shtator 2006, *Shënim Informativ 81*; *R.K. and A.K. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [38000/05](#), 30 shtator 2008, *Shënim Informativ 111*; *Dojan dhe të tjerë kundër Gjermanisë* (dec.), [319/08](#) et al., 13 shtator 2011, *Shënim Informativ 144*; si dhe raportin informativ mbi *Të drejtat Prindërore dhe Udhëzim për Nenin 2 i Protokollit nr 1*. (e drejta për arsim))

## **Neni 1 i Protokollit Nr. 1.**

### **Neni 1, par 2 i Protokollit Nr. 1**

#### **Kontrolli i përdorimit të Pronës**

Sekuestrimi parandalues i sendeve pasurore që u përkasin menaxherëve ose të afërmeve të drejtuesve të një banke në falimentim, edhe pasi ata u konstatuan të përfshirë personalisht: *shkelje*

***Uzan dhe të Tjerë kundër Turqisë*** - A.nr. 19620/05, 41487/05, 17613/08 et al. Vendimi 5.3.2019 (Seksioni II)

**Faktet** – Në vitin 2003 rregullatori bankar ia transferoi menaxhimin e një banke në falimentim fondit të sigurimit të depozitave të kursimit (*Tasarruf Mevduatı Sigorta Fonu* – TMSF), një institucion publik. TMSF-ja u pagoi kompensim zotëruesve të depozitave të bankës për një shumë të përgjithshme prej më shumë se 4 miliard Euro. Filloi çështja penale në ngarkim të aksionerëve të shumicës së bankës dhe disa menaxherëve ose auditëve. Duke u ngadalësuar për shkak të fshehjes së disa të pandehurve, gjykimi i drejtorëve të shoqërisë në Gjykatën e Asizit nuk ka përfunduar as deri më sot.

Në gusht të vitit 2003, Gjykata vendosi të urdhëronte sekuestrimin parandalues të sendeve pasurore, nga njëra anë, të drejtorëve të shoqërisë dhe disa menaxherëve dhe auditëve, dhe nga ana tjetër, të bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Kërkuesit u përkasin njërit prej këtyre dy grupeve. Procedimi penal fillimisht u shtri mbi ta por rezultoi me ndërprerje për të gjithë atë në vitin 2004; menaxherët dhe auditët morën pafajësi në lidhje me akuzat e reja në vitin 2008. Pjesa më e madhe e masave provizore megjithatë u lanë në fuqi, në pritje të shqyrtimit në themel dhe mbledhjes së borxheve publike.

**Ligji** – Neni 1 i Protokollit Nr. 1:

(a) *Nëse ka patur posedim* – Neni 1 i Protokollit Nr. 1: ishte i zbatueshëm, duke përfshirë çështjen e dy kërkuesve (lindur më 1999 dhe 2003) të cilët



ishin të mitur dhe që nuk kishin posedim faktik në momentin përkatës. Gjykatat kishin njohur zotësinë e tyre për të përfutur të drejta të caktuara nëpërmjet trashëgimisë ose dhurimit. Kërkesit i rinj në këtë mënyrë kishin pritshmëri të ligjshme që përfshihej në konceptin e ‘posedimit’, duke patur parasysh, për më tepër, natyrën automatike, të përgjithshme dhe jo-fleksible të masave provizore dhe kohëzgjatjen e tyre të pasigurt.

(b) *Natyra e ndërhyrjes* – Masat provizore duhej të shqyrtoheshin në aspektin e kontrollit të përdorimit të pronës.

(c) *Ligjshmëria* – Në kontekstin e pasigurisë në lidhje me rezultatin e procedimit penal në ngarkim të atyre të prezumuar përgjegjës për humbjet - duke ditur mosparaqitjen e të pandehurve -, legjislacioni i zbatueshëm u mundësonte gjykatave të vendosnin mbajtjen në fuqi masat provizore për sa kohë shumat e kërkuara nga TMSF-ja nuk ishin rikuperuar. Duke patur parasysh konstatimet e saj për proporcionalitetin më poshtë, Gjykata megjithatë e pa të përshtatshme të linte mënjane çështjen nëse një diskrecion i tillë i gjerë e përmbushte kriterin e ligjshmërisë.

(d) *Nëse ka patur një qëllim legjitim* – Masat e debatuar kishin qenë në interesin e përgjithshëm: parandalimi i përdorimit të pronës së dyshuar si e përfutur me të ardhura nga krimi.

(e) *Proporcionaliteti* – Gjykata njohur rëndësinë dhe kompleksitetin e kësaj çështjeje për autoritetet financiare, administrative dhe gjyqësore turke: ishte e nevojshme të merreshin masa me qëllim që të mbroheshin të drejtat e shumë individëve të cilët ishin të prekur nga situata, për të zbutur çdo humbje dhe të parandaluar mashtrimin, rikuperuar fondet publike dhe ndjekur ata që ishin përgjegjës për humbjet. Me synimin e ndalimit të transferimeve mashtruese të parave publike, masat e përkohshme mund të përbënin një armë eficient dhe të nevojshme për të luftuar mashtrimin në rrethet financiare. Zbatimi fillestar i këtyre masave, në vetvete, nuk është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

Megjithatë, ndërsa masat e përkohshme mund të justifikoheshin me interesin e përgjithshëm nëse synimi i tyre ishte për të parandaluar mashtrimin, me qëllim që të garantohej shpërblimi i kreditorëve, ato duhej

të ndërpriteshin menjëherë sapo të mos vazhdonin të ishin të nevojshme, pasi ndikimi i tyre rritej së bashku me kohëzgjatjen. Faktikisht, problemi kishte lindur veçanërisht nga data kur procedimi ishte ndërprerë në përfitim të kërkuësve.

Rëndësia e barrës së vendosur mi kërkuësit mund të shihet si më poshtë:

(i) *Kohëzgjatja* e kufizimeve: dhjetë vjet për disa kërkuës; deri në pesëmbëdhjetë vjet për të tjerët.

(ii) *Shtrirja* e kufizimeve: të dy kërkuësve të rinj u ishte hequr mundësia e përfutimit të llojeve të ndryshme të pronës; tre të tjerëve u ishte hequr akses, përkatësisht, tek pagat e tyre si lektorë universiteti, kursimet ose banesa (dhe për secilin prej tyre, tek makina).

(iii) *Natyra automatike*, e përgjithshme dhe jo-fleksible e kufizimeve, pa asnjë shqyrtim të rregullt individual. Jo vetëm që kërkuësit nuk ishin fajësuar nga një gjykata penale, por urdhrat e pagesës së nxjerrë ndaj tyre ishin anuluar nga gjykatat kompetente, e cila në këtë mënyrë kishte vendosur që ata nuk mund të mbaheshin përgjegjës për dëmin pasuror të pësuar nga TMSF-ja.

(iv) *Mungesa nga dosja e provave* për të sugjeruar që kërkuësit mund të ishin përfshirë në ndonjë mashtrim. Autoritetet e brendshme vetëm i parashikuan masat alternative tepër vonë, nëse e bënë këtë. Për më tepër, nuk kishte asgjë në dosje që të tregonte që mbledhja e borxheve publike kërkonte një mbrojtje më të mirë se prona e kërkuësve.

(v) *Në nivelin e garancive procedurale*, caktimi nga Gjykata e Asizit për disa prej kërkuësve të një 'statusi të ndryshëm nga ai i palëve në gjykim' i kishte penguar ata dhe akoma i pengon ata të marrin pjesë në gjykim, nga i cili varen të drejtat e tyre.

Pa patur asnjë justifikim përveç faktit që ata ishin të afërm të drejtorëve të bankës ose që ata kishin përgjegjësi në bankë në një moment të caktuar, caktimi i sekuestrimit parandalues në ngarkim të sendeve në posedim të kërkuësve dhe vazhdimi i tyre automatikisht pavarësisht vendimit të ndërprerjes ose pafajësisë nuk ishin në përputhje me parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës: ishte e nevojshme, nëpërmjet

ballafaqimit, që një gjykatë të vlerësonte se cilat instrumente ishin më të përshtatshme sipas rrethanave, dhe, në përgjithësi, për të peshuar balancën e qëllimit legjitim në fjalë dhe të drejtat e atyre që prekeshin. Për më tepër, kërkuesit nuk patën përfitimin e asnjë prej garancive të përkatëse procedurale. Shkurt, nuk ishte gjetur asnjë balancë e drejtë.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri për kërkuesit madhorë; gjashtë vota me një për dy kërkuesit e mitur).

Neni 4: nën rezervë.

## II. AKTGJYKIMET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHTETEVE TË TJERA ME RËNDËSI TË VEÇANTË PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE

### Neni 5

#### Neni 5-1

#### Arresti ose ndalimi i ligjshëm

Refuzimi për rishikimin e vendimit që ka rezultuar në dënimin e kërkuarit *in absentia*: shkelje

***Stoichkov kundër Bullgarisë* - A.nr. 9808/02 Vendimi 24.3.2005 (Seksioni I)**

**Faktet** – Kërkuari u largua nga Bullgaria në vitin 1988. Në vitin 1989, pas gjyqimit në mungesë, ai u dënua për përdhunim dhe përdhunim të mbetur në tentativë dhe u dënua me dhjetë vjet burgim. Në vitin 2000 ai u kthye në Bullgari dhe u arrestua dhe u fut në burg për të vuajtur dënimin. Kërkesa e tij për tu liruar - bazuar në argumentin që afati i parashkrimit prej dhjetë vjetësh për ekzekutimin e vendimit të tij kishte skaduar - u rrëzua nga prokurorët e rrethit të rajonalë si dhe Prokurori i Gjykatës së Kasacionit, ku të gjithë ishin të mendimit që periudha ishte ndërprerë nga disa masa të marra me synim realizimin e ekzekutimit të dënimit. Në vitin 2001, Gjykata e Lartë u shpreh se kërkesa e tij për rishikimin e vendimit penal ishte e papranueshme pasi dosja e çështjes ishte asgjësuar në vitin 1997, gjë që e bënte rishikimin në praktikë të pamundur. Kërkesa e tij rikrijimin e dosjes- së çështjes nuk pati sukses.

**Ligji** – Neni 5, par 1(a) - Gjykata nuk gjeti asnjë tregues që kërkuari kishte hequr dorë nga e drejta për tu paraqitur dhe të mbrohej në gjykimin

në ngarkim të tij në vitin 1989. Kështu, ai duhej të kishte mundësinë që ky vendim të rishikohej dhe faktet e akuzës së përdhunimit të provoheshin në praninë e tij. Qysh nga 1 janari 2000, e drejta bullgare e parashikonte shprehimisht këtë mundësi. Megjithatë, kur kërkuesi kërkoi që çështja e tij të rihapej, Gjykata e Lartë e Kasacionit e refuzoi këtë, kryesisht mbi faktin që dosja- e çështjes së gjykimin fillestar ishte asgjësuar, që, në mendimin e saj, e bënte rigjykimin në praktikë të pamundur. Ai duket se nuk mori asnjë përgjigje për kërkesën e tij për rikrijimin e dosjes- së çështjes. Në këtë mënyrë atij i ishte hequr mundësia e përfuturit nga një gjykatë, e cila e kishte dëgjuar atë, të provimit të fakteve të akuzave për të cilat ai ishte dënuar.

Për pasojë, gjykimi penal në ngarkim të kërkuesit, i kombinuar me pamundësinë e përfuturit të një provimi të ri të akuzave në ngarkim të tij nga një gjykatë që e kishte dëgjuar atë, ishte haptazi në kundërshtim me parimet e shprehura në Nenin 6. Kështu, ndërsa privimi fillestar i lirisë në vitin 2000 mund të konsiderohej i justifikuar sipas Nenit 5, par 1(a), duke u zbatuar për qëllimin e ekzekutimit të një dënimit të ligjshëm, ai pushoi së qeni i tillë në vitin 2001, ndërsa Gjykata e Lartë e Kasacionit kishte refuzuar të rishikonte vendimin.

***Përfundimi:*** shkelje (njëzëri).

Neni 5, par 4 - Argumenti i kërkuesit që dënimi i tij nuk mund të ekzekutohej më tej pasi kishte skaduar afati i parashkrimit ngrinte çështjen e faktit që ishte përcaktues për ligjshmërinë e ndalimit të tij, që ishte e pavarur dhe e dalluar nga shpallja fajtor dhe dënimi në vitin 1989. Ndërsa ligjshmëria e ndalimit të tij nuk ishte i qartë ai duhej të kishte mundësinë që çështja e tij të zgjidhej nga një gjykatë që përmbushte kërkesat e Nenit 5, par 4. Sipas së drejtës bullgare, të gjitha çështjes që preknin ligjshmërinë e ekzekutimit të dënimeve me burgim i besoheshin prokurorit publik. Nuk kishte asnjë dispozitë që të parashikonte shprehimisht rishikimin gjyqësor të këtyre çështjeve dhe asnjë procedurë *habeas corpus* që të zbatonte të gjitha llojet e heqjes së lirisë.

**Përfundimi:** shkelje (njëzëri).

Neni 5, par 5 - E drejta bullgare nuk i jepte kërkuarit të drejtën e ekzekutueshme për kompensim për shkeljet e konstatuara.

**Përfundimi:** shkelje (njëzëri).

Neni 41 - Gjykata u shpreh që forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes së Nenit 5, par 1(a), do të ishte rishikimi i vendimit dhe rigjykimi i kërkuarit në pajtim me të gjitha kërkesat e një gjykimit të drejtë. Gjykata i dha kërkuarit 8 000 Euro për dëmin jo-pasuror dhe i dha gjithashtu edhe një kompensim për kostot dhe shpenzimet.

*Shih çështjen e paraqitur për përgjigje: **Sali Nuredini kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë** A.nr . 38823/14.*

## **Neni 8**

### **Neni 8-1**

#### **Respektimi i jetës familjare**

Përshtatshmëria e masave të marra nga autoritetet për të ekzekutuar vendimet gjyqësore që urdhërojnë kthimin e fëmijëve tek nëna e tyre: shkelje

**Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë** – A.nr. 31679/96 Vendimi 25.1.2000 (Seksioni I)

**Faktet** – Kërkuarja, Rita Ignaccolo-Zenide, shtetase franceze, kishte lindur në vitin 1953 dhe banon në Metz (Francë). Pas divorcit të saj, një gjykatë franceze vendosi, në vendim që kishte marrë formë të prerë, që të dy fëmijët nga martesja të banonin me të. Në vitin 1990, gjatë pushimeve verore, fëmijët shkuan të shkonin me ish-bashkëshortin e saj; ai kishte shtetësi të dyfishtë franceze dhe Rumune dhe banonte në Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, në fund të pushimeve, ai refuzoi

t'ia kthente ata kërkueses. Pas ndryshimit të adresave për të disatën herë, me qëllim që tu shpëtonte autoriteteve amerikane, të cilave u ishte referuar çështja sipas Konventës së Hagës të 25 tetorit 1980 për Rrëmbimin Ndërkombëtar të fëmijëve, ai mundi të arratisë në Rumani në mars 1994, ku ai ka vazhduar të banojë deri më sot. Në 14 dhjetor 1994, Gjykata e Bukureshtit e Shkallës së Parë nxori një masë të përkohshme që kërkonte që fëmijët të ktheheshin tek kërkuesja. Megjithatë, përpjekjet për ekzekutimin e masës së përkohshme nuk patën sukses. Qysh nga viti 1990, kërkuesja i ka parë fëmijët e saj vetëm një herë, në një takim të organizuar nga autoritetet rumune në 29 janar 1997. Kërkuesja u ankua që mosekzekutimi nga ana e autoriteteve rumune të masës së përkohshme të nxjerrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Bukureshtit më 14 dhjetor 1994 përbënte shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës familjare, të garantuar nga Neni 8 i Konventës.

**Ligji** – Neni 8 i Konventës - Gjykata përsëriti që megjithëse objekti thelbësor i Nenit 8 ishte mbrojtja e individit ndaj veprimit arbitrar të autoriteteve publike, ai vendoste gjithashtu detyrime pozitive që janë pjesë përbërëse e 'respektit' efektiv të jetës familjare. Neni 8 përfshinte një të drejtë të prindërve për masat e marra me synim qenien të bashkuar me fëmijët e tyre dhe një detyrim të autoriteteve të brendshme për të marrë këto masa. Ky detyrim nuk ishte absolut, meqenëse mund të kërkohej përgatitje para ri-bashkimit të një prindi me një fëmijë i cili ka jetuar për një kohë të gjatë i ndarë me prindin tjetër. Natyra dhe masa e përgatitjes varej nga rrethanat e secilës çështje dhe çdo detyrim i autoriteteve për të aplikuar forcë në këtë fushë ishte i kufizuar, pasi duhej të merreshin parasysh interesat dhe të drejtat dhe liritë e të gjithëve personave të përfshirë, dhe veçanërisht interesat prioritare të fëmijës dhe të drejtat e tij sipas nenit 8 të Konventës. Nëse kontakti me prindin mund të kërcënonte këto interesa ose ndërhynte me këto të drejta, u takonte autoriteteve të brendshme të gjenin një balancë të drejtë ndërmjet tyre. Gjykata ishte e mendimit që detyrimet pozitive që vendoste Neni

8 i Konventës për Shtetet Kontraktues për të ndihmuar prindërit të ribashkohen me fëmijët e tyre duhej të interpretoheshin nën dritën e Konventës së Hagës të datës 25 tetor 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës. Ky qëndrim ishte posaçërisht i rëndësishëm për çështjen para Gjykatës, meqenëse Shteti i paditur ishte palë në këtë instrument. Faktori vendimtar për Gjykatën ishte të përcaktonte nëse autoritetet shtetërore kishin marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të lehtësuar urdhrin e datës 14 dhjetor 1994. Megjithëse përpjekjet e para për ekzekutimin e masës së përkohshme ishin marrë menjëherë, në dhjetor 1994, Gjykata vuri re që qysh nga janari 1995, përmbaruesit bënë vetëm dy përpjekje të mëtejshme: në maj dhe dhjetor 1995. Ajo vuri re gjithashtu që autoritetet nuk ndërmorën asnjë veprim ndërmjet dhjetorit 1995 dhe janarit 1997 dhe për këtë pasivitet nuk është sjellë asnjë shpjegim i arsyeshëm nga Qeveria. Për më tepër, autoritetet nuk kishin bërë as punën bazë për ekzekutimin e urdhrit, pasi ata nuk kishin marrë masat detyruese ndaj D.Z-së që të përgatisnin kthimin e fëmijëve, për shembull, organizimi i takimeve me psikiatrot dhe psikologët e fëmijës. Në përgatitjen e takimit të datës 29 janar 1997 nuk mori pjesë asnjë punonjës social apo psikolog. Përfundimisht, Gjykata vuri re që autoritetet nuk kishin zbatuar masat e parashikuara në Nenin 7 të Konventës së Hagës për të siguruar kthimin e fëmijëve tek kërkuesja. Gjykata konstatoi që autoritetet rumune kishin dështuar në marrjen e masave të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të respektuar të drejtën e kërkueses për kthimin e fëmijëve të saj dhe në këtë mënyrë kishin shkelur të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj familjare, të garantuar nga Neni 8. Gjykata nxori përfundimin që ka patur një shkelje të Neni 8.

**Konkluzion:** shkelje (6 vota me 1).

Neni 41 i Konventës - Gjykata u shpreh që kërkuesi duhej të kishte pësuar dëm jo-financiar siç pretendoi. Duke vendosur mbi një bazë të arsyeshme, i jep asaj 100 000 FRF për këtë shkak. Ajo i dha kërkueses 86 000 FRF për kostot dhe shpenzimet.



*Shih çështjen e paraqitur për përgjigje: **Valbone Oluri kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë**, A.nr. 3368/18.*

## **Neni 8**

### **Neni 8-1**

#### **Respektimi i jetës private**

Deklarimi i pajustificuar i të dhënave mjekësore konfidenciale në lidhje me refuzimin nga Dëshmitarët e Jehovahit për t’iu nënshtruar një transfuzioni gjaku: *shkelje*

**Avilkina dhe të Tjerë kundër Rusisë** - A.nr. 1585/09 Vendimi 6.6.2013 (Seksioni I)

**Faktet** – Në vijim të disa ankesave ndaj një organizate fetare, në vitin 2007 një Zëvendësprokuror i qytetit të Shëm Petersburgut kërkoi që të gjitha institucionet mjekësore të raportnin çdo refuzim për transfuzion gjaku nga Dëshmitarët e Jehovahit. Kur kërkuesja e dytë iu nënshtrua kemioterapisë në një spital publik pas një plani trajtimi menaxhimi pa përdorim gjaku, mjekët e saj njoftuan prokurorin për këtë rast. Po ashtu kartela mjekësore e kërkueses të katërt iu deklarua një zyre prokurorie pasi ajo refuzoi të përdorte gjak të huaj për trajtimin mjekësor në spitalin shtetëror. Në procedimet pasuese gjyqësore, gjykatat e brendshme e konstatuan deklarin e të dhënave mjekësore për kërkueset si të ligjshëm.

**Ligji** – Neni 8: Duke kujtuar që mbrojtja e të dhënave personale, duke përfshirë informacionin mjekësor, ishte e një rëndësie të madhe për gëzimin e së drejtës së respektimit të jetës private, Gjykata njohti që interesat e një pacienti dhe komuniteti si një i tërë në mbrojtje të konfidencialitetit të të dhënave mjekësore mund të tejkalohen nga interesat e ndjekjes së krimit dhe në publicitetin e procedimeve gjyqësore. Autoritetet kompetente të brendshme gëzonin gjithashtu

marzhin e vlerësimit në këtë fushë, objekti i të cilit varej nga natyra dhe serioziteti i interesave në fjalë dhe ashpërsia e ndërhyrjes. Megjithatë, kërkueset nuk ishin të dyshuara ose të akuzuara në procedime penale dhe prokurori po kryente një hetim në këto aktivitete të organizatës fetare në përgjigje të ankesave të marra nga zyra e tij. As institucionet mjekësore ku kërkuesit iu nënshtruan trajtimit nuk raportuan raste të sjelljes së pretenduar kriminale nga ana e kërkuesve. Posaçërisht, u takonte mjekëve që ofronin trajtimin për kërkuesen e dytë, e cila në momentin përkatës ishte dy vjeç, të kërkonin autorizim nga gjykata për transfuzion gjaku nëse ata besonin që ajo ishte në një situatë që i kërcënonte jetën e saj. Po ashtu, asgjë nuk sugjeronte që refuzimi i kërkueses së katërt për transfuzionin e gjakut ishte rezultat i presionit nga ndjekës të tjerë të besimeve të saj fetare dhe që nuk ishte shprehje e vullnetit të saj të vërtetë. Për pasojë, nuk kishte ndonjë nevojë urgjente sociale për kërkimin e deklarimit të informacionit mjekësor konfidencial në lidhje me kërkueset. Në fakt, prokurori kishte opsione të tjera të disponueshme për të ndjekur kërkesat që ai kishte marrë, si përpjekja për të marrë pëlqimin e kërkuesve për deklarimin e të dhënave mjekësore ose marrja e tyre në pyetje për këtë çështje. Megjithë këtë, prokurori kishte zgjedhur të urdhëronte deklarimin e informacionit mjekësor konfidencial pa u bërë njoftim apo dhënë mundësi kërkueseve të kundërshtonin apo të bënin ankim.

***Përfundimi:*** shkelje (njëzëri).

Neni 41: 5 000 Euro secilës për kërkuesen e dytë dhe të katërt në lidhje me dëmin jo-financiar.

***Shih çështjen e paraqitur për përgjigje: J.M. dhe A. T. kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 79783/13***

## Neni 10

### Neni 10-1

#### Liria e shprehjes

Dënimi për shpifje në lidhje me deklarimet gazetareske të paraqitura në një format pyetjeje dhe trajtuara si deklarime faktesh nga gjykatat e brendshme: *shkelje*

**Falzon kundër Maltës** – A.nr. 45791/13 Vendimi 20.3.2018 (Seksioni IV)

**Faktet** – Zëvendësudhëheqësi i Partisë së Punës së Maltës (MLP), M.F., mbajti një fjalim në të cilin ai informoi publikun që ai kishte marrë një e-mail anonim dhe letra kërcënuese, në lidhje me të cilat ai ishte ankuar drejtpërdrejt tek Komisioneri i Policisë duke i kërkuar atij të hetonte çështjen. Kërkuesi publikoi një opinion në gazetën *Maltatoday*, duke komentuar për fjalimin e tij dhe duke vënë në pikëpyetje mënyrën në të cilën të dy partitë politike e perceptonin forcën policore. Artikulli përmbante një sërë pyetjesh:

‘A nuk e ka përdorur Zëvendësudhëheqësi i ML-së (M.F.) me sukses forcën policore për të kontrolluar lirinë e një qytetari privat të pafajshëm, që i bindet ligjit të cilin ai e dyshonte të ishte një kundërshtar politik? A nuk ka abuzuar dikush në forcën policore me kompetencat e veta duke pranuar ta bëjë këtë në interes të grupit të drejtuar nga (M.F.) në grindjet e brendshme të MLP-së? Pse duhej të ndërhynte forca policore në politikën e brendshme të Punës, është e dukshme, që ka shumë mami që po e vdesin fëmijën?’

‘Pra, çfarë po bën Qeveria për këtë? A ka Zëvendësudhëheqësi i MLP-së më shumë peshë dhe ndikim tek Komisioneri i Policisë se Zëvendëskryeministri i cili është politikisht përgjegjës për Forcën Policore?’

Në përgjigje, zëvendësudhëheqësi nisi çështjen penale për shpifje në ngarkim të kërkuesit. Gjykata e brendshme e dënoi kërkuesin për shpifje dhe e urdhëroi atë të paguajë gjobë (2 500 Euro). Ankimet i kërkuesit nuk u rrëzuan.

Në gjykimin në bazë të ankimit kushtetues, kërkuesi pretendoi që gjykatat e brendshme i kishin veshur atij insinuata ose pretendime që ai nuk i kishte bërë apo nënkuptuar në këtë artikull, si deklarimet në lidhje me faktin që M.F. kishte ‘manipuluar’ Komisioneri i policisë, dhe ky i fundit kishte rënë pre e presionit që kishte ‘penguar ushtrimin e funksionit të tij’ dhe që M.F. ishte një *deus ex machina* që tërhiqte fijet e forcës Policore. Në lidhje me serinë e pyetjeve në këtë artikull, kërkuesi argumentoi që ato i drejtoheshin lexuesit për t’iu përgjigjur.

Gjykata Kushtetuese i konsideroi pyetjet në fjalë si pretendime fakti dhe la në fuqi konkluzionet e gjykatave më të ulëta që kërkuesi nuk kishte mundur të mbështeste pretendimet e tij faktike në lidhje me në presion të paligjshëm dhe abuziv mbi policinë nga zëvendësudhëheqësi i MLP-së.

**Ligji** – Neni 10: Rezultati i gjykimit për shpifje përbënin një ndërhyrje tek e drejta e lirisë së shprehjes së kërkuesit. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte një qëllim legjitim që ishte ai i mbrojtjes së reputacionit ose të drejtave të të tjerëve.

Deklarimet që ishin bërë në format pyetjeje duket se ishin shkaku kryesor i dënimit të kërkuesit. Gjykatat e brendshme u kishin veshur atyre kuptime që nuk ishin të shprehura shprehimisht dhe për pasojë konsideruan që ato ishin thënie faktike të pavërteta. Gjykata nuk ra dakord me përfundimet e gjykatave të brendshme, duke kujtuar interpretimin e gjerë dhe liberal të ‘gjykimeve të vlerës’ në lidhje me lirinë gazetareske për çështjet e interesit publik, posaçërisht në lidhje me politikanët. Duke përdorur një stil provokativ, ishte normale që kërkuesi për nxiste ndërgjegjësimin në lidhje me mundësinë e kryerjes së një abuzimi nga zëvendësudhëheqësi i një partie opozitare dhe në këtë mënyrë po shprehte shqetësimet e tij për një çështje me interes

publik. Kështu, pyetjet e ngritura nga kërkuesi ishin pyetje legjitime duke patur bazë të mjaftueshme faktike: fjalimin e vetë M.F.-së.

Për më tepër, Gjykata nuk ishte e bindur që deklaratimet e debatuar mund të konsideroheshin si një sulm që të arrinte pragun e kërkuar të ashpërsisë dhe në gjendje për të shkaktuar cenimin e gëzimit të jetës private nga M.F.-ja. Kështu, caktimi i rimbursimit në favor të tij do të kishte efekt ftohës.

Në tërësi, gjykatat e brendshme nuk kishin kryer një ushtrim balancimi ndërmjet nevojës për të mbrojtur reputacionin e paditësit dhe lirinë e shprehjes së kërkuesit.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Neni 41: 4 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; 2 500 Euro në lidhje me dëmin financiar.

*Shih çështjen e paraqitur për përgjigje nga **Jadranka Kostova dhe Vlado Apostolov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë**, nr. 38549/16.*

## **Neni 1 i Protokollit Nr. 1.**

### **Neni 1, par 2 i Protokollit Nr. 1**

#### **Kontrolli i përdorimit të Pronës**

Humbja e parave të kërkuesit të zotëruara ligjërisht për shkak të mosraportimit tek autoritetet doganore: shkelje

**Ismayilov kundër Rusisë** – A.nr. 30352/03 Vendimi 6.11.2008 (Seksioni I)

**Faktet** – Kërkuesi mbërri në Moskë nga një udhëtim nga Bakuja duke patur në zotërim 20 000 USD, para në dorë, që ai i kishte përfutur nga shitja e një apartamenti të trashëguar. Megjithatë sipas ligjit rus, çdo

shumë mbi 10 000 USD duhej tu raportojë autoriteteve doganore, kërkuesi nuk e bëri këtë. Autoritetet i gjetën paratë në bagazhin e tij, i sekuestruan dhe e akuzuan për kontrabandë. Ai në vijim u dënua sipas akuzës dhe iu dha në dënim me burgim gjashtë-mujor të pezulluar me kusht. Paratë - të cilat konsideroheshin si provë fizike në kryerjen e veprës penale u konfiskua.

**Ligji** – Shtetet kanë një interes të ligjshëm dhe gjithashtu një detyrë në një sërë traktatesh ndërkombëtare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, për të zbatuar masa për të zbuluar dhe monitoruar lëvizjen e parasë në kufijtë e tyre, meqenëse shumat e mëdha të parave mund të përdoren për vepra penale të rënda financiare. Megjithatë, origjina e ligjshme e parave të kërkuesit nuk ishte e debatueshme. Ai nuk kishte precedent penale dhe nuk ishte i dyshuar për pastrim parash, korrupsion ose vepra të tjera të rënda financiare. Vepra penale për të cilën kërkuesi u dënua përbëhej nga mosdeklarimi i parave që ai kishte fizikisht tek autoritetet doganore. Thjesht fakti i futjes së monedhës së huaj në Rusi nuk ishte e paligjshëm sipas së drejtës ruse; përkundrazi, ajo duhej vetëm të deklarohet tek autoritetet doganore. Shuma e konfiskuar ishte natyrisht e konsiderueshme për kërkuesin, pasi kjo përfaqësonte të gjitha të ardhurat nga shitja e shtëpisë së nënës së tij të ndarë nga jeta në Baku. Dëmi që kërkuesi mund të kishte shkaktuar autoriteteve ishte minimal: ai nuk kishte shmangur detyrimet doganore apo ndonjë detyrim tjetër apo ti kishte shkaktuar ndonjë dëm pasuror Shtetit. Nëse shumata nuk do të ishte zbuluar, autoritetet ruse thjesht nuk do të kishin informacionin që këto para kishin hyrë në Rusi. Kështu, masa e konfiskimit nuk ishte e destinuar si kompensim pasuror për dëmin - pasi Shteti nuk kishte pësuar ndonjë dëm si rezultat i mosdeklarimit të parave nga ana e kërkuesit - por ishte në qëllimin e vet pengues dhe ndëshkues. Megjithatë, meqenëse kërkuesi ishte dënuar tashme për veprën penale të kontrabandës nëpërmjet dënimit penal, efekti i dëshiruar pengues ishte arritur. Në këto rrethana, Gjykata nuk ishte e bindur që masa e konfiskimit ishte e nevojshme. Përkundrazi, ajo ishte

e tepërt dhe jo-proporcionale dhe vendoste një barrë individuale dhe të lartë mbi kërkuesin.

***Përfundimi:*** shkelje (gjashtë vota me një)

Neni 41 - 20 000 EURO në lidhje me dëmin financiar; 5 000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

*Shih përgjigjen e paraqitur: **Besim Neziri kundër Republikës së Maqedonisë**, A.nr. 55347/17.*

### III. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

#### Neni 8

#### Neni 8-1

#### E drejta e privatësisë

***X. Kundër Republikës së Maqedonisë<sup>1</sup>*** - A. nr. 29683/16, aktgjykim nga data 17.01.2019

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ, Gjykata) më datë 17 janar të vitit 2019 miratoi aktgjykim për çështjen **X. Kundër Republikës së Maqedonisë** me të cilin konstatoi shkelje të Nenit 8 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) i cili e garanton të drejtën e jetës private dhe familjare, për shkak të mungesës së kuadrit ligjor i cili do të mundësojë njohje të identitetit gjinor të aplikantit (person transgjinor), përmes ndryshimit të shenjës së seksit në evidencën e amzës dhe në këtë mënyrë do të sigurohet respektimi i jetës private të aplikantit.

***Faktet*** – Aplikanti, një person transgjinor, u ankua se në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë i është imponuar kushti për t’iu nënshtruar operacionit gjenital me qëllim që personi të mund ta ndryshojë shenjën e tij të seksit/gjinisë në evidencën e amzës. Në pretendimet ankimore qëndron se aplikanti është diagnostikuar si transseksual dhe çdo detyrim për t’iu nënshtruar operacionit për shkak të njohjes së ndryshimit të shenjave të seksit në dokumente do të nënkuptonte sterilizim të detyrueshëm dhe nënshtrim të detyrueshëm për trajtim mjekësor e që është në

---

<sup>1</sup> Pas hyrjes në fuqi më 12 shkurt 2019 të Marrëveshjes Përfundimtare sipas njoftimit të duhur drejtuar Organizatave ndërkombëtare, emri zyrtar i Shtetit të paditur është Republika e Maqedonisë së Veriut – versioni i shkurtuar: Maqedonia e Veriut.



kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga ana e shtetit.

Në vitin 2011, aplikanti e ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin e tij, me ç'rast i është lëshuar kartë e re identiteti dhe pas një kohe të shkurtër ka parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Evidencës së Regjistrave të Amzës (Drejtoria) për ndryshimin e shenjës së seksit në evidencën e tij të amzës.

Në fillim të procedurës vendase, e cila akoma është në rrjedhë e sipër para institucioneve vendase, Drejtoria e ka refuzuar kërkesën e aplikantit si të pabazë, me arsyetim se aplikanti nuk ka parashtruar vërtetim të lëshuar nga organi kompetent në lidhje me atë se seksi i tij me të vërtetë ka pësuar ndryshim. Me vendimin e fundit të miratuar para publikimit të aktgjykimit nga ana e GJEDNJ, të miratuar në vitin 2018, Drejtoria e ka hedhur poshtë kërkesën e aplikantit për shkak të moskompetencës, duke konsideruar se nuk ka të bëjë me korrigjimin e gabimit në dokument, por me ndryshimin e shenjës së seksit/gjinisë në evidencën e amzës.

Krahas faktit se procedura vendase e aplikantit nuk kishte vendim të formës së prerë, para parashtrimit të aplikimit në GJEDNJ, megjithatë Gjykata e pranoi si të pranueshëm për shkak të procedurës së stërzgatur epilogu i së cilës është mjaft i paqartë, në mungesë të legjislacionit përkatës vendas i cili i rregullon çështjet kontestuese ose të praktikës përkatëse vendase.

**Vlerësimi i GJEDNJ:** Gjatë shqyrtimit të çështjes, GJEDNJ, i bëri një vështrim legjislacionit ndërkombëtar siç është Rekomandimi CM/Rec (2010) i Komitetit të Ministrave nga data 31 mars të vitit 2010; Rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës nga data 22 prill të vitit 2015 dhe 29 prill të vitit 2010 dhe Raporti i Komisionarit të Lartë pranë Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut nga data 17 nëntor të vitit 2011 (shih §§ 32-35 të aktgjykimit). Edhe pse bëhet fjalë për të ashtuquajturën *drejtësi e butë*, rekomandimet e lartpërmendura kryesisht kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave përkatëse me të cilat përmes procedurës së shpejtë, transparente dhe të qasshme, shtetet do të krijojnë mundësi për njohje ligjore të seksit të preferuar (preferred gender) në dokumentet zyrtare.

Nga ana tjetër, GJEDNJ konstatoi se njohja ligjore e gjinisë së personave transgjjinor nuk është rregulluar në 7 nga gjithsej 47 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, në mesin e të cilave edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në grupin prej 7 shteteve përveç Qipros nuk ka asnjë shtet tjetër anëtar i BE-së (shih § 35 të aktgjykimit).

Me aktgjykimin e miratuar më datë 17 janar të vitit 2019, GJEDNJ konstatoi se në legjislacionin aktual të shtetit, sa i përket njohjes ligjore të gjinisë, janë detektuar boshllëqe ligjore dhe mangësi serioze të cilat kanë pasojë afatgjata negative mbi shëndetin mendor të aplikantit meqë nuk ofron përgjigje për shumë çështje të rëndësishme, në mesin e të cilave edhe çështja për ekzistimin dhe natyrën e kushteve të cilat aplikanti duhet t'i përmbushë që të ketë mundësi ta ndryshojë shenjën e seksit/gjinisë në evidencën e amzës. GJEDNJ konstatoi se duke i marrë parasysh rrethanat nuk mund të bëjë spekulime nëse shteti do t'i mundësojë aplikantit, i cili i është nënshtruar trajtimit hormonal dhe ka bërë operacion të pjesshëm (mastektomi e dyfishtë), t'i njihet identiteti i preferuar gjinor.

**Konkluzion:** Shkelja e Nenit 8 nga KEDNJ

**Dëshmëpërblim i drejtë:** 9,000 euro (nëntë mijë euro) në bazë të dëmit jomaterial.

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

**Tasev kundër Maqedonisë së Veriut - 9825/13** Vendimi 16.5.2019 (Seksioni I)

Refuzimi për të regjistruar një ndryshim në etnicitetin e vetë-deklaruar të kandidatit në një periudhë zgjedhesh, pa bazë ligjore të parashikueshme: shkelje

**Faktet** – Në shtator 2012 u publikua një njoftim për një vend bosh në lidhje me vendet në Këshillin Gjyqësor Shtetëror (KGS) për tu zënë nga gjyqtarët në detyrë të zgjedhura nga radhët e tyre. Enticiteti nuk ishte përfshirë tek kërkesat e deklaruara për këto vende. Kërkuesi, një gjyqtar i cili u përpoq të dilte si kandidat, kërkoi që e dhëna e tij për etnicitetin në listën zgjedhore të ndryshohej nga bullgare në maqedone. Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat e të dy shkallëve të gjykimit nuk e plotësuan këtë kërkesë për shkaqet e mëposhtme: (i) ishte paraqitur pas publikimit të shpalljes së zgjedhjes së anëtarëve të rinj për në KGS; (ii) kishte të bënte me të drejtat zgjedhore të kërkuesit në zgjedhjen pasuese për anëtarët e rinj të KGS-së; dhe (iii) do ti vendoste gjyqtarët e tjerë në përfshirë në zgjedhje në një pozicion të pavaforshëm.

**Ligji** – Neni 8 Gjykata ishte shprehur më parë që identiteti etnik ishte një detaj që i përkiste identitetit individual që përfshihej në sferën personale të mbrojtur nga Neni 8. Në referim të konsideratave të fundit në lidhje me aspektet pozitive dhe negative të së drejtës së vetë-identifikimit të lirë të anëtarëve të minoriteteve kombëtare në të drejtën ndërkombëtare - jo vetëm në Këshillin e Europës [Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare](#) —, Gjykata gjithashtu përsëriti që çdo anëtar i një minoriteti kombëtar kishte të drejtën e plotë të zgjidhte të mos trajtohej si i tillë.

Duke patur parasysh faktin që ligji i brendshëm u jepte të drejtën (dhe u kërkonte) gjyqtarëve të deklaroin identitetin e tyre etnik në listën zgjedhore brenda kontekstit të zgjedhjeve për në KGS-së, refuzimi i autoriteteve për të ndryshuar të dhënat e etnicitetit të kërkuesit në listën zgjedhore përbënte ndërhyrje në 'jetën e tij private'.

Duke ditur mungesën e çdo kërkesë si arsyetimi objektiv i etnicitetit të vetë-dekluar, arsyeja kryesore për refuzimin në fjalë dukej se kishte të bënte me momentin e kërkesës së kërkuesit, e para në kontekstin e pjesëmarrjes së tij si kandidat në zgjedhjet pasuese për në KGS.

Megjithatë, asnjë nga dispozitat e referuara nga Gjykata e Lartë Administrative kishte të bënte me listën zgjedhore ose korrigjimin e hollësive që përmbaheshin atje; faktikisht, këto çështje ishin të rregulluara nga dispozita të tjera, që ishin ato të seksionit 17 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor Shtetëror. As nuk ishte argumentuar që kishte një rrugë tjetër gjyqësore për kërkuesin në lidhje me këtë kërkesë.

Sipas seksionit 17 të këtij Ligji, çdo kërkesë për korrigjimin e hollësive të regjistruara, duke përfshirë përcaktimin e entitetit të tyre, duhej të bëhej pasi lista zgjedhore tu ishte ofruar për inspektim, që, në vetvete, mund të bëhej vetëm pas shpalljes publike për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KGS-së. Kjo dispozitë ishte e përcaktuar në tema të përgjithshme dhe zbatohet për të gjithë gjyqtarët, te dhënat personale të të cilëve ishin të regjistruara në listën zgjedhore. Ajo nuk përmbante asnjë dispozitë që të specifikonte më tej apo të kufizonte zbatueshmërinë dhe e kushtëzonte këtë, për shembull, me rrethana të caktuara që zbatohen për ankimuesin në këtë rast konkret. Faktikisht, në këtë dispozitë nuk kishte asgjë që mund të interpretohej sikur pengonte (d.m.th., përjashtonte) gjyqtarët që kandidonin për tu zgjedhur në KGS nga kërkimi i korrigjimit të të dhënave të tyre personale në listën zgjedhore (duke përfshirë përcaktimet e etnicitetit të tyre), në vijim të publikimit të shpalljes së një zgjedhjeje të tillë. Megjithatë, autoritetet nuk zgjodhën këtë interpretim, i cili nuk mund të thuhet se ishte i parashikueshëm. Për më tepër, kërkuesi nuk mund të pritej që në mungesë të një dispozite për këtë efekt, që kërkesa e tij të dështonte për këto shkaqe.

Për pasojë, megjithëse ishte e aksesueshme, baza ligjore mbi të cilën mbështetej një refuzim i tillë i debatuar, nuk ishte e parashikueshme.

**Përfundimi::** shkelje (gjashtë vota me një)

Neni 41: 4,500 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu, në lidhje me identitetin etnik që përfshihet në objektin e Nenit 8 të Konventës, *Aksu v. Turkey* (DHM), [4149/04](#) dhe [41029/04](#), 15 mars 2012, [Shënim Informativ 150](#), dhe *S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar* (DHM), [30562/04](#) and [30566/04](#), 4 dhjetor 2008, [Shënim Informativ 114](#); në lidhje me konsideratat mbi aspektet negative mbi të drejtën e vetë-identifikimit të lirë të anëtarëve të minoriteteve kombëtare, *Molla Sali kundër Greqisë* (DHM), [20452/14](#), 19 dhjetor 2018, [Shënim Informativ 224](#); në lidhje me refuzimin e regjistrimit të identitetit etnik të deklaruar të kërkuesit në bazën e të dhënave të Regjistrimit shtetëror të Popullatës, *Ciubotaru kundër Moldovës*, [27138/04](#), 27 prill 2010, [Shënim Informativ 129](#))

## Neni 10

### Liria e shprehjes

***Makraduli kundër Republikës së Maqedonisë<sup>2</sup>*** – A. nr. 64659/11 dhe 24133/13, aktgjykim nga data 19.07.2018

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ, Gjykata) më datë 19.07.2018 miratoi aktgjykim për çështjen **Makraduli kundër Republikës së Maqedonisë**, me të cilin konstatoi shkelje të Nenit 10 nga Konventa, i cili e garanton lirinë e shprehjes, në dy çështje të ndryshme vendase në të cilat është konstatuar dënimi i aplikantit për veprën penale shpifje.

**Faktet** – Procedura e të dy aplikimeve u bashkua duke e pasur parasysh faktin se të dy aplikimet u parashtruan me pretendime identike për shkelje të Nenit 10 nga KEDNJ; nga aplikanti i njëjtë; në të dyja çështjet bëhet fjalë për deklarime kontestuese të cilat aplikanti i ka bërë në konferencë për shtyp në periudhën kohore kur ai ka qenë nënkryetar i partisë politike opozitare dhe deputet në Kuvendin e RM; si dhe fakti se në të dyja këto çështje në lidhje me të cilat GJEDNJ konstatoi shkelje të Nenit 10 nga KEDNJ, paraqiten palët e njëjta, përkatësisht në të dyja çështjet si i dëmtuar në procedurat vendase paraqitet S. M. i cili në periudhën kohore të deklarimeve kontestuese ka qenë anëtar i lartë i partisë politike në pushtet dhe drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim.

Njëri nga deklaratimet kontestues ka të bëjë me pretendimin e shpërdorimit të pajisjeve për përgjim të DSK lidhur me tregtimin në bursë, ndërsa deklarimi tjetër ka të bëjë me shitjen e truallit ndërtimor në pronësi shtetërore në zonën qendrore të Qytetit të Shkupit, ku është planifikuar të ndërtohet hotel. Të dy deklaratimet kontestuese datojnë nga viti 2007.

<sup>2</sup> Pas hyrjes në fuqi më 12 shkurt 2019 të Marrëveshjes Përfundimtare sipas njoftimit të duhur drejtuar Organizatave ndërkombëtare, emri zyrtar i Shtetit të paditur është Republika e Maqedonisë së Veriut – versioni i shkurtuar: Maqedonia e Veriut.

**Vlerësimi i GJEDNJ:** GJEDNJ në të dyja çështjet konstatoi se dënimi penal i aplikantit nënkupton ndërhyrje, përkatësisht intervenim në lirinë e shprehjes së aplikantit, se intervenimi i këtillë ka qenë në përputhje me ligjin, përkatësisht është bazuar në dispozitat atëherë të vlefshme të Kodit Penal të RM; se të dyja procedurat kishin qëllim identik legjitim – mbrojtje të autoritetit të S. M., por edhe atë se në të dyja çështjet dënimi penal i aplikantit si intervenim, përkatësisht si ndërhyrje në lirinë e shprehjes së aplikantit, nuk ka qenë proporcional në raport me qëllimin legjitim për realizimin e të cilit janë bërë përpjekje që të arrihet, përkatësisht se dënimi penal “nuk ka qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, konform Nenit 10 paragrafit 2 të KEDNJ.

**Konkluzion:** Shkelja e Nenit 10 nga KEDNJ

**Dëmshtëpërblim i drejtë:** 1.500 (një mijë e pesëqind) euro në bazë të dëmit jomaterial dhe 1.020 (një mijë e njëzetë) për kompensimin e shpenzimeve të bëra në procedurën para GJEDNJ.

## Neni 9

### Liria e fesë

## Neni 11

### Liria e tubimit

**Bashkësia Bektashiane dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë<sup>3</sup>**  
– A. nr. 48044/10; 75722/12 dhe 25176/13, aktgjykim nga data 12.04.2018

Më datë 12.04.2018, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut miratoi aktgjykim për çështjen **Bashkësia Bektashiane dhe të tjerë kundër**

<sup>3</sup> Pas hyrjes në fuqi më 12 shkurt 2019 të Marrëveshjes Përfundimtare sipas njoftimit të duhur drejtuar Organizatave ndërkombëtare, emri zyrtar i Shtetit të paditur është Republika e Maqedonisë së Veriut – versioni i shkurtuar: Maqedonia e Veriut.

**Republikës së Maqedonisë** me të cilin konstatoi shkelje të Nenit 9 (liria e fesë) në lidhje me Nenin 11 (liria e tubimit) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

**Gjendja faktike:** Aplikimet për të cilat u bashkua procedura, u parashtruan nga bashkësia e paregjistruar religjioze – Bashkësia Bektashiane dhe dy themeluesit e saj – z. Edmond Brahimaj nga Tetova, si bartës i pozitës më të lartë hierarkike në shtet dhe z. Arben Sulejmani nga Gostivari. Të dy themeluesve – persona fizikë, GJEDNJ nuk ua njohu legjitimacionin aktiv në procedurën para GJEDNJ.

Shoqata fetare – aplikante ka funksionuar pa pengesë si organizatë e njohur fetare nga viti 1993. Në vitin 2007 me hyrjen në fuqi të Ligjit për pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, në përputhje me këtë Ligj, shoqata aplikante i është drejtuar me kërkesë gjykatës vendase (gjykatës për regjistrim) që t’ia njoh vazhdimësinë juridike. Megjithatë, kjo kërkesë është refuzuar për shkaqe formale, përkatësisht me Vlerësimin se nuk ka qenë e regjistruar para vitit 1998, por ka qenë e paraqitur vetëm si bashkësi fetare në vitin 2000, ndërsa vendimi është konfirmuar edhe nga gjykata më e lartë. Në këtë periudhë kohore organizata ka qenë e popullarizuar edhe si “Bashkësia Islame Bektashiane”.

Pas refuzimit të kërkesës për njohjen e vazhdimësisë juridike, si përpjekje për harmonizimin e punës së kësaj shoqate fetare me dispozitat e Ligjit nga viti 2007, e njëjta në vitin 2010 ka parashtruar kërkesë “të re” për regjistrim “të ri” në përputhje me Ligjin nga viti 2007 mirëpo kërkesa e këtillë është refuzuar, fillimisht për shkak se gjykatat vendase përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese të RM, kishin konstatuar se emërtimi me të cilin kërkohet të bëhet regjistrimi (Bashkësia Fetare Bektashiane) në vete ka përmbajtur referencë të njëjtë si të organizatës tanimë të regjistruar fetare “Grupi Religjioz Bektashian Ehli Bejti në Maqedoni” ndërsa burimet e mësimi fetar kanë qenë identikë si të Bashkësisë Islame Fetare dhe sipas kësaj regjistrimi i kërkuar do të krijonte huti dhe konfuzion tek besimtarët.

Aplikantët, veç tjerash, u ankuan edhe për shkeljen e Nenit 14 nga KEDNJ (ndalimi i diskriminimit) dhe shkeljen e Nenit 6 nga KEDNJ (e drejta e gjykimit të drejtë).

**Vlerësimi i GJEDNJ:** GJEDNJ konstatoi se shoqatës - aplikante nuk i është njohur vazhdimësia juridik vetëm për shkaqe formale. Ajo, në mënyrë plotësuese, ka pranuar se kufizimi i cili rezulton nga refuzimi i njohjes së vazhdimësisë juridik ka qenë në përputhje me ligjin, por jo edhe atë se kjo ka pasur qëllim legjitim, si dhe atë se gjykatat vendase nuk kanë njoftuar për ekzistimin “e nevojës së domosdoshme dhe të nevojshme shoqërore”, për refuzimin e kërkesës të njihet vazhdimësia juridik i shoqatës - aplikante. Në Vlerësimin e konkluzionit të vet, se refuzimi i kërkesës së shoqatës – aplikante nuk ka qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike, GJEDNJ në masë të madhe mbështetet në faktin se shoqata ka ekzistuar dhe ka funksionuar në mënyrë të pakontestueshme para miratimit të Ligjit në vitin 2007, fakt të cilin nuk e ka trajtuar asnjë nga autoritetet vendase të cilët kanë vendosur për kërkesën e shoqatës – aplikante, ndërsa në mungesë të shkaqeve të ndryshme nga ana e organeve gjyqësore të cilat kanë vendosur për kërkesën, Qeveria para GJEDNJ po ashtu nuk ishte në gjendje të nxjerr kurrfarë arsyetimesh, përkatësisht nuk kishte mundësi t’iu referohet shkaqeve të cilat i kanë konstatuar organet gjyqësore vendase.

GJEDNJ mori qëndrim se intervenimi në të drejtën e tubimit fetar të shoqatës aplikante, ka qenë në përputhje me ligjin dhe ka pasur qëllim legjitim – mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, megjithatë nuk ka qenë e arsyeshme sepse sipas GJEDNJ, emërtimi me të cilin është kërkuar regjistrimi ka qenë mjaft i ndryshëm nga emërtimi “Grupi Religjioz Bektashian Ehli Bejti në Maqedoni”, duke i përfshirë këtu edhe dallimet e formës së organizimit, ndërsa nga ana tjetër institucionet vendase nuk e kanë marrë parasysh faktin e ekzistimit shumëvjeçar paraprak paralel të BIF dhe shoqatës aplikante, dhe as faktin se ekzistimi i tyre i këtillë, në të kaluarën, ka krijuar konfuzion. Interpretimin e burimeve të mësimin të shoqatës aplikante nga ana e gjykatave vendase GJEDNJ e vlerësoi si të kundërt me pozitën neutrale e cila kërkohet nga shteti; GJEDNJ, veç tjerash, konstatoi se institucionet vendase gjatë procedurës së regjistrimit nuk kanë bërë dialog me shoqatën aplikante, ndërkohë të njëjtat nuk kanë njoftuar se regjistrimi eventual i shoqatës aplikante do të paraqes ndonjë rrezik për shoqërinë demokratike ose se refuzimi i regjistrimit të saj ka qenë



i domosdoshëm që të parandalohen konfliktet fetare. Sipas GJEDNJ refuzimi i regjistrimit të shoqatës fetare, e cila ka ekzistuar dhe në mënyrë legale ka funksionuar në shtet, shumë kohë para miratimit të Ligjit nga viti 2007, duhet të konsistojë me argumente jashtëzakonisht të fuqishme dhe bindëse, të cilat nuk i kanë poseduar.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, GJEDNJ konstatoi shkelje të Nenit 11 në lidhje me Nenin 9 të KEDNJ, lidhur me të dyja procedurat vendase, si sa i përket procedurës në të cilën shoqata aplikante ka kërkuar njohje të vazhdimsisë juridike, ashtu edhe sa i përket procedurës tjetër për regjistrimin “e ri” sipas Ligjit të vitit 2007.

GJEDNJ konstatoi se bazat për të cilat aplikantët pohonin shkelje të ndalimit të diskriminimit tanimë janë absolutuar me shkeljen e konstatuar të KEDNJ dhe se për këto shkaqe nuk ka nevojë të vendos për pretendimet e shkeljes së Nenit 14 të KEDNJ. Ajo njëkohësisht në mënyrë evidente e refuzoi si të pabazë pretendimin për shkelje të Nenit 6 nga KEDNJ për shkak të mos mbajtjes së diskutimit publik në procedurën vendase.

**Konkluzion:** Shkelja e Nenit 11 në lidhje me Nenin 9 të KEDNJ

**Dëmshpërblim i drejtë:** 5.000 euro (pesë mijë euro) në bazë të dëmit jomaterial dhe 2.000 euro (dy mijë euro), kompensim për shpenzimet e bëra në procedurën para GJEDNJ.

Shih aktgjykimet: *“Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit pranë Patriarkanës së Pejës)” kundër Republikës së Maqedonisë* (A. nr. 3532/07), *“Manastiri Stavropegial Shën Gjon Gojarti” kundër Republikës së Maqedonisë*, *“Kisha e të Krishterëve të Vërtetë Ortodoks” dhe Ivanovski kundër Republikës së Maqedonisë* (A. nr. 52849/09).

## Neni 41

### Kompensim i drejtë (dëmi material)

***Stojanovski dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë<sup>4</sup>*** - A. nr. 14174/09, aktgjykim nga data 07.02.2019

Më 23 tetor të vitit 2014, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut miratoi aktgjykim për çështjen Stojanovski dhe të tjerë kundër **Republikës së Maqedonisë**, A. nr. 14174/09, në të cilin konstatoi shkelje të së drejtës së pronësisë të garantuar me Nenin 1 të Protokollit nr. 1 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut meqë institucionet kompetente vendase refuzuan tua kthejnë aplikantëve në pronësi të tyre truallin e parcelës, konform procedurës për denacionalizim. Nga ana tjetër, GJEDNJ e përcaktoi shumën e kompensimit të dëmit jomaterial, ndërsa për aspektin e kompensimit të dëmit material do të vendos në mënyrë plotësuese. Shuma e caktuar e dëmit jomaterial aplikantëve iu pagua në kohë.

Në procedurën para GJEDNJ aplikantët kërkuan kompensim të dëmit material në lartësi prej 300.000 euro, shumë për të cilën pohonin se korrespondon me vlerën aktuale në treg të parcelës në fokus të çështjes KP nr. 2943/6, e cila gjendet në Rasadnik në rajonin e Komunës Kisella Vodë.

Në aktgjykimin e vitit 2014, GJEDNJ sa i përket kompensimit të dëmit material, GJEDNJ i bëri apel Qeverisë dhe banorëve që në afat prej tre muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ta njoftojnë për çdo lloj ujdje të cilën mund ta arrijnë në lidhje me dëmin material.

***Dëshmipërblim i drejtë:*** Në mungesë të ujdisë midis aplikantëve dhe Qeverisë, GJEDNJ me aktgjykimin e datës 7 shkurt të vitit 2019 vendosi në lidhje me kërkesën për dëmin material të aplikantëve, i cili rezulton nga shkelja e të drejtës së pronësisë të konstatuar me

---

<sup>4</sup> Pas hyrjes në fuqi më 12 shkurt 2019 të Marrëveshjes Përfundimtare sipas njoftimit të duhur drejtuar Organizatave ndërkombëtare, emri zyrtar i Shtetit të paditur është Republika e Maqedonisë së Veriut – versioni i shkurtuar: Maqedonia e Veriut.

aktgjykimin e GJEDNJ nga viti 2014, në mënyrë që shteti e ka për detyrë aplikantëve tua bartë në pronësi, në afat prej tre muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, truallin në zonën e njëjtë siç është parcela nr. 2943/6 karakteristikat dhe vlerat e së cilës të jenë sa është e mundur më identike me parcelën kontestuese nr. 2943/6 (e zvogëluar me vlerën e fletë-obligacioneve shtetërore që u janë dhënë aplikantëve në procedurën e denacionalizimit), ndërsa si alternativë nëse shteti nuk mund ta përmbush detyrimin e lartpërmendur, atëherë shteti brenda afatit të njëjtë prej tre muajsh aplikantëve duhet tua paguaj shumën në lartësi prej 190.000 euro.

Shih aktgjykimin: *Stojanovski dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë* - A. nr. 14174/09, aktgjykim nga data 23 tetor të vitit 2014.

# IRZ



Мakavej, 2019